



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 06/23

Rahovec, 19.6.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e gjashtë (6), e cila do të mbahet më 27 qershor 2023 (e martë), me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar – qershor 2023) të kryetarit të Komunës;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – 2024 - 2026;
5. Shqyrtimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
6. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00386-1 ZK-Pastasellë;
7. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00364-0 ZK- Polluzhë;
8. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01031-0 ZK-Polluzhë;
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00331-0 ZK - Mrasor;
10. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01987-0 ZK -Opterushë;
11. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00050-0 ZK-Opterushë;
12. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01015-12 ZK-Xërxe;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01313-3 ZK-Rahovec;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.63/23, i datës 28.4.2023, për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë”;
15. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe të lagjeve urbane;
16. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Shërbime Publike;





01 Br. 06/23
Orahovac, 19.06.2023

Pozivamo članove Skupštine Opštine da prisustvuju na šestu (6) redovnu sednicu koja će se održati **27. juna 2022 (utorak)**, sa početkom u 10:00, u sali S.O Orahovac

Za ovu sednicu predlažem sledeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika prethodne sednice;
2. Pitanja i odgovori na pitanja odbornika;
3. Razmatranje šestomesečnog izveštaja Predsednika Opštine (Januar-Jun) 2023. godine;
4. Razmatranje Srednjoročnog Okvira Budžeta (S.O.B) - 2024-2026;
5. Razmatranje predloga-odluke za prenos sredstava od 2022. do 2023. godine;
6. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-00386-1, K.Z Pustoselo;
7. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-00364-0, K.Z - Poluže;
8. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-01031-0, K.Z - Poluže;
9. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-00331-0, K.Z - Mirasor;
10. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-01987-0, K.Z - Opteruše;
11. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-00050-0 K.Z - Opteruše;
12. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-01015-12 K.Z - Zrze;
13. Razmatranje predloga-odluke za objavu od opšteg javnog interesa, P-01313-3 K.Z – Orahovac;
14. Razmatranje i usvajanje predloga odluke za ukidanje odluke 01 Br. 63/23 od 28.04.2023, za zaštitu "Kantiona Beli Drim";
15. Razmatranje izveštaja komisije za izbor lokalnih odbora sela i gradskih naselja;
16. Razmatranje informacija odeljenja za javne usluge;

REPUBLIKA E KOSOVES
KUUVENDI I KOMUNES
RAHOVEC
SKUPSHINA OPSTINA ORAHOVAC
MUNICIPAL ASSEMBLY OF RAHOVEC
PREDSIEDAYALUČI SKUPŠTINE
Betirin Kafexhin



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Odgojenje za Urbanizam, Planiranje i Zaštita Sredine

26 09.06.23
RAHOVEC - ORAHOVAC

Informatë për gjendjen e mbeturinave në Komunën e Rahovecit



PËRMBLEDHJE

Një ndër sfidat kryesore në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë mbetet menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave. Me gjithë arritjet dhe progresin në forcimin e bazës ligjore dhe programore për sektorin e mbeturinave, me gjithë përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e tyre, mbetet ende angazhim dhe punë për përmirësimin e gjendjes në sektorin e mbeturinave.

Ne jemi të vetëdijshëm se për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave nevojitet një bashkëpunim më efikas dhe i qëndrueshëm i institucioneve dhe i organizatave përgjegjëse në të gjitha nivelet.

Përveç angazhimit të institucioneve ligjvënëse dhe ekzekutive, rol të rëndësishëm në sektorin e mbeturinave kanë edhe kompanitë menaxhuese të grumbullimit të mbeturinave, kompanitë që menaxhojnë deponitë sanitare të mbeturinave, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe aktorët e tjerë.

Aktualisht, vështirësitë dhe problemet në sektorin e mbeturinave janë evidente në të gjitha proceset e menaxhimit të tyre, që nga grumbullimi, ndarja, riciklimi, trajtimi dhe deponimi.

Por, besojmë fuqishëm që me një angazhim dhe kordinim më të mirë Komuna e Rahovecit mund të arrijë të ndërtojë një sistem modern dhe funksional për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave do të ndihmojë në realizimin e synimit primar që ka Komuna e Rahovecit, përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit dhe resurseve tona natyrore për ne dhe për gjeneratat që do të vijnë pas nesh.

Të nderuar!

Në duart tuaja keni Raportin për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale.

Ky raport është përgatitur nga Zyrtarja e lartë për mjedis në Komunën e Rahovecit Bjondina Ramaj- Fazliu, në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi për raportim për gjendjen e mbeturinave sipas Ligjit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ligjit për Mbeturina.

Qëllimi kryesor i Raportit është informimi i publikut për gjendjen e mbeturinave komunale në Komunën e Rahovecit, mirëpo përmes këtij raporti synohet që të ndikohet edhe në përmirësimin e politikave për menaxhimin e mbeturinave.

1. RAPORT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

- Operatorët e Menaxhimit të Mbeturinave
- Menaxhimi i Mbeturinave
- Sfidat në Menaxhimin e Mbeturinave
- Korniza lokale ligjore
- Masat aktuale për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave
- Gjendja ekzistuese

Në Komunën e Rahovecit menaxhimi i mbeturinave nuk është në gjendje të keqe vetëm duhet të vetëdijesohemi mos të hedhim mbeturina vend e pa vend që të krijojmë deponi ilegale, kemi punuar edhe jemi duke punuar vazhdimisht ti largojmë deponitë ilegale po ashtu edhe jemi në përfundim të aksionit me të gjitha shkollat e komunës sonë.

Kemi organizuar kampanjën për largimin e deponive ilegale gjithmonë me raportet nga GIZI gjerman dhe nga Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit poashtu edhe Jica japoneze ka bërë regjistrimin në muajin shtator të deponive ilegale.

Janë larguar deponitë me përmasa të mëdha në fshatra dhe qytet

Bashkë duhet të vetëdijesohemi se mbeturinat nuk kemi nevojë ti hedhim në ambiente të pastërta por duhet ti kthejmë në hapësira gjelbëruese për ne dhe fëmijët tanë- "*Ambienti i Pastër jeta e Shëndetshme*".

SFIDAT NË MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është përballur me plotë sfida për një kohë të gjatë tani. Ndërsa ende përpiqet të krijojë një sektor stabil me impakte negative të imponuara në mjedis dhe shëndet publik, organizatat ndërkombëtare janë duke i dhënë rëndësi të madhe çështjes së mbeturinave, dhe duke e bërë këtë që të ndihmojë Kosovën të arrij një zhvillim mjedisor të qëndrueshëm.

Sfidat në menaxhimin e mbeturinave janë :

- Mbeturinat kimike industriale ,
- Mbeturinat medicinale ,
- Mbeturinat shtazore dhe
- Mbeturinat elektronike të cilat nuk janë drejtpërdrejtë në kompetencë të komunës edhe pse në komunën tonë nuk kemi mbeturina kimike dhe elektronike por mbeturina shtazore dhe medicinale .

KORNIZA LOKALE LIGJORE

Bazuar në kornizën kushtetuese në të cilën principe autoritetet kosovare qeverisin, duhet garantuar mbrojtja e mjedisit për qytetarët. Sipas nenit 7, “Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”.

Komuna ka përzgjedhur deponinë ku do të hedhen mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi.

Mbulimi i shërbimeve në territorin e Komunës është i përfshirë në të gjithë territorin e komunës sonë në 36 vendbanimet.

Komuna jonë ka përfitu për GRANTIN PËR GARËN PËR MJEDIS TË PASTËR vlera e pergjithshme e grantit 390.913.00 euro kontinjera jane shpenzuar 137.475.00 euro kurse vlera e mbetur per kamion 253.438 ku ende nuk e kemi marre kamioni per menaxhim te mbeturinave .Në Komunën tone ne përkrahje për kontejnerë rreth kontejnerë 120 litarësh nje sasi e konsiderueshme eshte shperndarë dhe 120 kontejnerë 1.1m3 .

Kurse me Japan International cooperation agency –Agjensioni japonez për bashkëpunim ndërkombëtar kemi bashkëpunim dhe jemi duke punuar vazhdimisht ne projektin trevjeçarë – Projekti për ngritjen e Kapaciteteve për Menaxhim te mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë Faza 2

- 1.Përmiresim të shërbimit te grumbullimit të mbeturinave në komunën ,
- 2.Përmirësim të burimeve financiare duke përcaktuar dhe mbledhur taksën e mbeturinave
- 3.Rritja e stafit në Sektorin e Menaxhimit te Mbeturinave
4. Përmirësimi i metodës së operimit të menaxhimit të kamionëve duke vendosur GPS në kamionët e mbledhjes së mbeturinave.

Projekti në dy faza nga maji 2021 deri në mars 2022 dhe faza e Implementimit nga prill 2022 deri në prill 2024. Ku ekspertët e Jica kanë synim që katër komunat të kenë sistem të qëndrueshëm Rahovec, Suharekë ,Malishevë dhe Dragash, dhe do te bëhen pilot projekt për menaxhim të qëndrueshëm.

Jemi në hapa të mire dhe gjithçka besoj do të rregullohet por ne jemi ata që duhet ti ndihmojmë mjedisit ku jetojmë ta menaxhojmë mbeturinat mirë që te kemi mjedis të pastër .

Komuna e Rahovecit duhet të përcaktojë mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare dhe caktimin e tarifave ,të bëjë vlerësimin e kompanive dhe monitorimin e tyre, gjithashtu të monitorohet mirë procesi i tenderimit, përzgjedhja e operatorit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe të zhvillojë pilot projektin për eliminimin e deponive ilegale dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në komunë.

Është aprovuar Rregullorja e Mbeturinave për territorin e Komunës së Rahovecit me datën 30.03.2023.

Tani jemi duke punuar rreth datbazës së të dhënave të ekonomive familjare poashtu projekti po vazhdon gjithçka është duke shkuar në rregull me kohë në bazë të projektit.

Me respekt Bjondina Ramaj-Fazliu Zyrtare e Lart për Mjedis .



The image shows a handwritten signature in blue ink above a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top, "Komuna e Rahovecit" in the center, "RAHOVAC" below it, and "ORAJI XII" at the bottom. There is also a small coat of arms in the center of the stamp.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Orahovac



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

Odeljenje za Opštu Upravu

III- Nr. l prot. 2131 Më 09-06-2023
Br. prot. DI.
RAHOVEC - ORAHOVAC

**KORNIZA AFATMESME
BUXHETORE (KAB)
E KOMUNËS SË RAHOVECIT
2024-2026**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2023

Përmbajtja:

Përmbajtja:	1
I. Hyrje	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:	6
2. Forcimi i sektorit të bujqësisë	6
2.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor, si:	7
2.2. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit	8
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim.....	8
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe i mirëqenies së qytetarëve	9
1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale.....	10
2. Administratë e Përgjithshme	12
3. Rinia, kultura dhe sporti	12
III. Korniza Fiskale Komunale	13
3.1.Indikatorët ekonomik komunal.....	13
3.2. Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2024-2026	15
3.3. Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2024-2026	18

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB-i siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave, prioritetëve, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuara nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2024/01, të lëshuara nga Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve, prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

I

Draft KAB - it 2024-2026

Fillimi i qershorit



II

Kuvendi Komunal dhe Konsultimet

Mesi i qershorit



III

Publikimi i dokumentit të KAB-it 2024-2026

Fundi i qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2024

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime të vogla dhe një qendër urbane, e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 1845 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale, që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të Komunës dhe 8 të tjera në fshatra, gjithashtu, Komuna e Rahovecit posedon tri E-kiosqe, një mundësi e mirë që qytetarëve u mundëson vetëshërbimin me dokumente administrative (certifikata të ndryshme).

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë, bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjate strategjike që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës dhe të prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2024-2026 (I), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Rahovecit është: ***"Të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, e arsimit dhe e jetës sportive. Po ashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj"***.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari, lehtësia e komunikimit, si dhe, së dyti, llogaridhënia, së treti, transparenca. Me qëllim të përmbushjes së këtyretributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të Komunës, në periudhën afatmesme, janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

PRIORITETET:

- **BUJQËSIA;**
- **EKONOMIA;**
- **AGROTURIZMI DHE PUNËSIMI;**
- **ADMINISTRATË BASHKËKOHORE ME SHËRBIME TË SHPEJTA DHE CILËSORE;**
- **ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE;**
- **INFRASTRUKTURË PUBLIKE TË RREGULLUAR DHE TË MIRËMBAJTUR;**
- **INVESTIME NGA FONDI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT;**
- **INVESTIME NË INFRASTRUKTURË KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË, SI DHE RRITJA E PËRKRAHJES PËR KËTA SEKTORË;**
- **PROMOVIMI I POTENCIALIT DHE I MUNDËSIVE PËR INVESTIME NGA MËRGATA JONË;**
- **TRASHËGIMIA KULTURORE, HISTORIKE DHE INVESTIME PËR TA NDERUAR HARTËN E SAKRIFICËS DHE TË LIRISË.**

ZOTIMET:

- **KOMUNË E HAPUR PËR QYTETARËT - TRANSPARENCË E PLOTË DHE LLOGARIDHËNIE;**
- **KOMUNË QË QEVERISËT DREJT DHE MIRË, LIGJSHËM DHE ME PERFORMANCË TË LARTË;**
- **KOMUNË KU U SHËRBEHET QYTETARËVE PA DALLIM;**
- **KOMUNË ME SHËRBIME GJITHNJË E MË BASHKËKOHORE;**
- **KOMUNË KU PROMOVOHEN POLITIKAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA, SI DHE STANDARDET E LARTA TË QEVERISJES;**
- **KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT NJERËZORE E QYTETARE;**
- **KOMUNË PA DISKRIMINIM E QË QYTETARËT I TRAJTON BARABARTË;**

- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT KOMBËTARE, HISTORIKE, VLERAT E LUFTËS DHE TË LIRISË;
- KOMUNË QË NDERON SAKRIFICËN DHE GJAKUN E DERDHUR PËR LIRI;
- KOMUNË QË TRAJTON DHE MBËSHTET QYTETARËT QË KANË NEVOJA TË VEÇANTA;
- KOMUNË QË NDERON, PROMOVON E I JEP PËRKRAHJE TRADITËS, TRASHËGIMISË DHE GJITHË PASURISË SONË TË PËRBASHKËT, GJITHË ASAJ QË ËSHTË VLERË DHE IDENTITET I RAHOVECIT;
- KOMUNË KU PËRFAQËSOHET, MBROHET DHE PUNOHET PËR INTERESIN PUBLIK;
- KOMUNË KU PËRKUSHTIMI PËR TË VEPRUAR NDERSHËM DHE NË PAJTIM ME LIGJIN, PËRVEÇSE VULLNET, PËRCAKTIM I TË ZGJEDHURVE, JETËSOHET EDHE SI DETYRIM MORAL NDAJ ZGJEDHËSVE, SI DHE NDAJ LIGJIT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHET MOZAIKU I VLERAVE NJERËZORE, DEMOKRATIKE, KULTURORE, TË TRASHËGIMISË E TË BESIMIT NË ZOT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN PAKICAT DHE PROMOVOHEN VLERAT E TYRE.

SYNIMET:

- BUJQËSI TË PËRKRAHUR PËR KATËR VJET;
- INVESTIME NË RRIJTEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, ZGJERIMIN E TYRE, ZGJATJEN E ORARIT TË SHËRBIMEVE, PAJISJE MJEKËSORE DHE INVENTARIZIM PËR QKMF-në DHE PËR TË GJITHË RRJETIN E SHËRBIMEVE PARËSORE SHËNDETËSORE;
- ARSIM CILËSOR DHE BIBLIOTEKA, PAJISJE BASHKËKOHORE, LABORATORË, MË SHUMË TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE MJETE KONKRETIZIMI NË SHKOLLA;
- HARTIMI I PLANEVE URBANE DHE NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT;
- KOLEKTORË DHE IMPIANT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA;
- ZHVILLIM EKONOMIK DHE PUNËSIM NËPËRMJET FUQIZIMIT DHE MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT;
- PËRQENDRIM PËR ZHVILLIMIN E PLANIFIKUAR TË AGROTURIZMIT;
- QENDËR E MADHE MAGAZINUESE PËR RUAJTJEN E RRUSHIT, PEMËVE DHE PERIMEVE.

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

Një ndër prioritet në mandatin qeverisës do të vazhdojë të mbetet zhvillimi ekonomik përmes politikave lehtësuese në taksa dhe mbështetje të bizneseve të reja, atyre të vogla dhe të mesme. Duke e pasur parasysh dëmin nga kriza pandemike, një qasje e re është e nevojshme për t'ua dhënë mundësinë e ringritjes bizneseve në komunën tonë.

- Funksionalizimi i Zonës Ekonomike në Optrushë – Aktualisht, Komuna e Rahovecit, ka memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Indutrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për fazën e parë të ndërtimit të Zonës Ekonomike. Vlera e këtij memorandum është: 1,800,00,00€ dhe Komuna e Rahovecit do të bashkëfinancojë me 300,000,00€. Kostoja totale e këtij projekti është: 2,672,756,06€. Komuna e Rahovecit, është e përkushtuar deri në funksionalizimin e plotë të këtij projekti, me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik lokal;
- Krijimi i hapësirave të reja për zhvillimin e bizneseve – Do të krijohen hapësira të reja për biznese në: Rahovec (pjesët më afër qytetit), Krushë të Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe në fshatrat më të mëdha e më të frekuentuara në komunën e Rahovecit. Gjithashtu, në zona ku ka potencial zhvillimi, do të përpiqemi të krijojmë lehtësira dhe hapësira për investime nga sektori privat;
- Lehtësira në të bërit biznes - Lehtësim i taksave komunale, sipas sektorëve – Do të bëhen vlerësimet e nevojshme për të siguruar uljen e taksave për bizneset private;
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve - Përkrahje për bizneset e reja, ato të vogla dhe të mesme. Me qëllim të përmirësimit të ambientit të të bërit biznes në komunë, do të ndihmohen veçanërisht sipërmarrësit e ri, të vegjël dhe të mesëm, përmes subvencionimit edhe të zejeve të veçanta dhe të aplikimit të taksave favorizuese për ta;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të moshuar;
- Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit dhe ndërtimi i shtigjeve të reja;
- Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare, si dhe dhënia në shfrytëzim përmes ankandeve publike;
- Mbështetja e turizmit dhe e agroturizmit;
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve;
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes;
- Investime në zona turistike;
- Rritje e përkushtimit dhe e intensitetit të veprimeve për projekte të ndryshme dhe suksese të reja në PPP;
- Përfshirje e të rinjve në tregun e punës, me përkrahje direkte nga komuna e cila synon krijimin e mjediseve të përshtatshme dhe përkrahje me teknologji informative, ku përmes ideve të reja e projekteve konkrete (inovative) të hapet perspektivë për ta;
- Promovimi i turizmit në komunën e Rahovecit.

2. Forcimi i sektorit të bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë, duke qenë e harmonizuar me politikat dhe strategjinë e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të strategjisë janë përfshirë të gjithë sektorët që zhvillohen në komunën tonë, me theks të veçantë: vreshtaria dhe perimekultura.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen programe të veçanta që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e kushteve të punës për fermerët kultivues të pemëve dhe të perimeve.

Fokusi në këtë periudhë do të orientohet në këto drejtime, si:

- Zbatimi i projekteve që prekin direkt fermerët;
- Zbatimi i projekteve kapitale për ndërtimin e infrastrukturës bujqësore, dhe
- Zhvillimi i sektorit të turizmit rural - agroturizmit.

2.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor, si:

- Perimekulturë dhe pemëtari – Përkrahje fermerëve me farëra, plehra kimike dhe me inpute bujqësore;
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra (sipërfaqe 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari, do të shohim mundësinë që kjo sipërfaqe të rritet në vazhdimësi);
- Përkrahja e bujqve për ngritje të fidanishteve për prodhim të fidaneve cilësore;
- Sektori i blegtorisë - shërbime veterinarë (vaksinimi, kontrollimi i kafshëve, repelimi etj.);
- Marrja e mostrave të tokave bujqësore për analiza;
- Sektori i bletarisë – investim në mbjellje me kultura të përshtatshme për bletë (Kolz),
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes;
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventarë;
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe të perimeve;
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit;
- Hapja e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë, si: funksionalizimi i tregut në Krushë të Madhe, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e tregut në qytetin e Rahovecit, po ashtu përfundimin e fazës së tretë të projektit “Infrastruktura e tregut të rrushit” - te Shtëpia e Verës;
- Në bashkëpunim me zyrën këshillimore, që operon në kuadër të MBPZHR-së, organizimin e trajnimeve për të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë;
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme, duke angazhuar ekspertë;

Menaxhimi me kujdes i tokës bujqësore komunale, duke i respektuar procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme përmes ankandit publik

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre;
- Ndërtimi i rrugëve fushore, me theks të veçantë mirëmbajtja e tyre;
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore;
- Pastrimi dhe zgjerimi i përrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni;
- Drenazhimi i tokave bujqësore;

- Rrjeti sekondar i sistemit të ujitjes në lokacione ku ekziston rrjeti primar, si dhe zgjerimi i rrjetit në pjesën kodrinore në koordinim me kompanitë publike, donatorët e jashtëm dhe Qeverinë që të kemi përparim dhe investime konkrete në këtë drejtim, në vitet e ardhshme qeverisëse për sigurim të ujit për ujitje, po ashtu, duke shfrytëzuar edhe burimet e tjera alternative të ujit.

2.2. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit

- Investimi në ngritjen e bujtinave dhe investimi në infrastrukturë në zonat e shpallura turistike, si: Hapësira të burimi-Zhdrella, Burimi dhe shtegu në fshatin Zatriq, Pishat në fshatin Kaznik, Hapësira të Maja e Shkodranit, Vendi i quajtur Bllata, Kanioni Drini i Bardhë, ku aktivitetet e agroturizmit, si pjesë të një ose më shumë kategorive, janë: mikpritja (qëndrimi ose fjetja në bujtina për një ose disa net), rekreacioni (p.sh. shtegu i ecjes, gjuetia, kalërimi), dhe argëtimi (p.sh. dreka ose darka).
- Hapja e një zyre për informim dhe krijimi i një guide për turistët rreth zonave turistike të identifikuara në komunën e Rahovecit;
- Promovimi i zonave të përshtatshme për zhvillim të turizmit përmes Hartave dhe shënimit në tërë territorin e komunës sonë;
- Organizimi i festivaleve të ndryshme, që kanë karakter promovimin e produkteve bujqësore, që kultivohen në komunën tonë, si: Festa e Vjeljes së Rrushit – HardhFest, Agrofesta, panaire të ndryshme etj;
- Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Mbrojtja dhe ruajtja e sipërfaqeve pyjore do të ketë vëmendje të shtuar;
- Toka, e cila është nën menaxhim të Agjensionit Pyjor të Kosovës (APK), do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim

- Ndërtimi dhe rinovimi i shkollave – Do të bëhet një rivlerësim i nevojës për objekte të reja shkollore në qytetin dhe fshatrat e Rahovecit. Në bazë të këtij rivlerësimi, Komuna e Rahovecit do të investojë që të rinovohen apo ndërtohen objektet e reja të arsimit fillor dhe të mesëm;
- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim;
- Eficienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave;
- Investime në mjete konkretizimi të laboratorike, teknologji informative, tabela digjitale dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra;
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, këshillave drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve;
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla përmes angazhimit të një numri të caktuar të psikologëve dhe të pedagogëve, tashmë të punësuar;
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimitdhënësve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim. Trajnimet do të mbahen sidomos me mësimitdhënësit fillestarë;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit edukativo - arsimor në shkolla, përmes Komisionit për Monitorim, të themeluar nga DKA-ja;
- Funksionalizimi i plotë i 3 çerdheve për fëmijë, të sapondërtuara.

- Organizimi dhe mbajtja periodike e garave të diturisë për nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar në shumicën e lëndëve mësimore;
- Zgjerimi i Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta – Siç e dimë, DKA-ja në katër vitet e fundit, në bashkëpunim me Ekipe Profesionale të saj, ka arritur që për herë të parë të hartojë dhe të vërë në përdorim Pakon Pedagogjike për klasat parafillore dhe klasat e programit fillor (1-5). Kjo Pako Pedagogjike është hartuar dhe tashmë do të vihet në përdorim edhe për klasat e larta (6-9), po ashtu edhe për klasat 10-12. Me zgjerimin e saj, në komunën tonë, do të ketë Pako Pedagogjike unike për të gjithë mësimdhënësit e të gjitha shkollave;
- Vazhdimi i funksionimit të suksesshëm të Qendrës Arsimore për nxënësit e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe themelimi i funksionalizimi edhe i një Qendre të Dytë Arsimore për këto komunitete në Shkollën Gëzim Hamza-Piktori. Komuna jonë do të kujdeset që Qendrat Arsimore për nxënësit e këtyre komuniteteve të vazhdojnë funksionimin e tyre normal, duke mundësuar arsimim dhe edukim shtesë për fëmijët e këtyre komuniteteve;
- Vazhdimi i funksionimit të Qendrës të Karrierës në SHML “Xhelal Hajda-Toni” dhe në IAAP “Selajdin Mullabazi – Mici”;
- Bursa për studentë dhe përkrahje gjithë atyre profesionistëve që na përfaqësojnë si komunë ose si shtet e na bëjnë krenar me dijet dhe shkathtësitë e tyre;
- Edukim për kategoritë me nevoja të veçanta – Komuna do të ofrojë transport, por edhe kushte specifike të mësimnxënies, duke iu përshtatur nevojave dhe kapaciteteve të tyre për vijimin e mësimi;
- Më shumë çerdhe – Qeverisja lokale, duke e parë nevojën për çerdhe të reja, do të investojë për hapjen e tyre në zona urbane, por edhe në vendbanime të mëdha rurale ku nuk ka çerdhe në afërsi, përmes Partneritetit Publiko- Privat, pas studimit të nevojave që do t'i kemi.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe i mirëqenies së qytetarëve

- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe të kualitetit të shërbimeve të ofruara;
- Investime në maternitet - Do të përmirësojmë kushtet në maternitetin e Rahovecit, përmes angazhimit të stafit profesional dhe të sigurimit të pajisjeve të reja për stafin shëndetësor;
- Ndihma momentale për pacientët me sëmundje terminale - Komuna e Rahovecit do të ndajë një fond për t'u dalë në ndihmë pacientëve me sëmundje të rënda, përmes mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve;
- Shëndeti mendor – Do të angazhojmë ekipe profesionale (psikologë, pedagogë, punëtorë social, logopedë etj.) për ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këto lloj shërbimesh, si dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për bashkëpunim sa më funksional dhe koordinim sa më të mirë me Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor në Gjakovë;
- Pediatri në QKMF dhe vizita pediatrie nëpër çerdhe – Departamenti i Pediatrisë në Komunën e Rahovecit do t'i rrisë kapacitetet dhe do të ofrojë shërbime të zgjeruara, siç është ofrimi i shërbimeve të pediatri nëpër çerdhet e komunës;
- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet;
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile;

- Kujdesi paliativ, kujdesi shtëpiak;
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jongjitëse;
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë;
- Shtimi i personelit shëndetësor;
- Vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve në shkolla. Rritja e shërbimeve laboratorike (shtimi i llojeve të analizave në QKMF);
- Rritja e shërbimeve specialistike në QKMF – këshillëdhënëse;
- Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi i objekteve shëndetësore, Administratës Komunale dhe hapësirave publike;
- Krijimi i hapësirave për karantinë (sëmundjet ngjitëse), objekti i QMF-së (në rast nevojë);
- Rritja e gamës së shërbimeve laboratorike;
- Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës sonë;
- Decentralizimi i shërbimeve mjekësore (QMF, AMF);
- Barna esenciale - Komuna do të ndajë buxhet për sigurimin e barnave esenciale për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit;
- Vizitë në shtëpi për gra shtatzëna, dhe fëmijët 0-3 vjeç;
- Funksionalizimi i urgjencës njëzet e katër orë, me dy mjekë specialistë, dhe katër infermierë.

1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale

- Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Pyllëzimi i hapësirave kodrinore;
- Inspektimi i shtuar për parandalimin e ndotjes dhe të shkatërrimit të mjedisit dhe krijimi i deponive për mbeturina të materialeve të forta, si dhe krijimi i hapësirave të gjelbra;
- Ndërtimi i parqeve të bukura dhe mirëmbajtja e tyre;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Planet e hollësishme rregulluese në qytet – Do të bëhet hartimi i planeve të hollësishme rregulluese, të cilat do të përcaktonin kushtet e detajuara të ndërtimit për lagjet e qytetit, formën e ndërtimit, të fasadës, të orientimit etj. Përmes implementimit të këtyre planeve, komuna do ta rriste mbledhjen e të hyrave, përmes lejeve të ndërtimit;
- Plane rregulluese për zonat rurale – Komuna do ta rregullojë planifikimin hapësinor të ndërtimeve edhe në fshatra, në mënyrë që të mbrohen tokat bujqësore, por edhe t'i zbatojë rekomandimet urbanistike, e që ndërtimet mos të pengojnë zhvillimin normal të jetës në këto vendbanime. Përmes planeve, ndërtimi në fshatra do të orientohet në toka të përshtatshme për ndërtim e që janë më jopjellore;
- PZHK dhe HZK - Do të miratohet Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës, pas shqyrtimit publik;
- Plani Lokal për Cilësinë e Ajrit;
- Plani Lokal për Biodiversitet;

- Pjesa e vjetër e qytetit – Komuna do t'i kushtojë vëmendje të veçantë pjesës së vjetër të qytetit, përmes një plani të detajuar, duke investuar në rrugët e vjetra me kalldrëm, por edhe në objektet përreth, pa ia humbur origjinalitetin dhe duke ia kthyer pamjen që e kishte më parë;
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve dhe i përrrenjve dhe trajtimi i shtretërve të tyre;
- Konkursi e projektimit – Do të vazhdojë organizimi i shpalljes së konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit për projektet e rëndësishme kapitale në komunën tonë. Përmes konkurseve të projektimit, bëhet e mundur që arkitektët më profesionistë të bëhen pjesë e arkitekturës së përgjithshme të komunës;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim i Kompleksit Përkujtimor në Gradish;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim i Kullës për heronjtë Toni dhe Mici dhe bashkëlufëtëtarët e tyre në Optrushë;
- Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit (në pjesën e vjetër të qytetit);
- Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit;
- Përfundimi i plotë i shtrirjes së ndriçimit në të gjitha vendbanimet;
- Rrugët, trotualet, riasfaltimi dhe shënjimi në qytet – Do të investohet në zgjerimin dhe rregullimin e trotualet për këmbësorë, në rrugët e reja e riasfaltimin e rrugëve të dëmtuara (sidomos ato që kanë qarkullim më shumë), si dhe në ripërtëritjen e shënjimit të tyre;
- Përfundimi i rrugicave nëpër fshatra;
- Renovimi dhe fasadimi i objekteve të përbashkta të banimit- Për t'ia dhënë një imazh estetik qytetit, si dhe për t'i bërë më eficientë në shpenzime të energjisë.
- Kolektorë dhe impiante për ujërat e zeza. Do të angazhohemi me donatorët të ketë investime konkrete në trajtimin e ujërave të zeza në tërë territorin e komunës së Rahovecit, përmes ndërtimit të kolektorëve dhe impianteve për trajtimin e tyre;
- Energjia e gjelbër - Energjia alternative do të praktikohet në vendosjen e objekteve publike përmes paneleve diellore, me qëllim të ekonomizimit dhe të zvogëlimit të shpenzimeve;
- Digjitalizim për mbikëqyrjen e rrjetit të ndriçimit publik - përmes sistemit online dhe Platformës PHONE MOBILE, do të mundësohet verifikimi dhe mbikëqyrja e drejtpërdrejtë;
- Digjitalizimi i infrastrukturës publike (Rrjeti i rrugëve të kategorizura dhe të pakategorizuara me gjithë instalimet nëntokësore përmes platformës WEB-GIS;
- Më shumë parkingje - Do të krijojmë hapësira të reja për parkingje veturash në disa pjesë të qytetit të Rahovecit dhe do të shenjëzohen hapësirat aktuale të parkingjeve;
- Mirëmbajtja e përgjithshme – mirëmbajtjes do t'i kushtohet rëndësi e veçantë, si një zgjidhje efikase për kursimin e parasë publike. Me mirëmbajtje, duke filluar nga rrugët, trotualet, parqet, varrezat, ndërtesat, drunjtë, ndriçimi publik dhe të gjitha asetet e infrastrukturës dhe të pasurive publike, do të shpenzohet më pak, sepse do të investohet në jetëgjatësinë e tyre;
- Lidhja ndërmjet vendbanimeve me rrugë të asfaltuara – asfaltimi i rrugëve që e lidhin qytetin me zonat rurale, është projekt i përfunduar, mirëpo ka nevoja të mëdha që lidhjet ndërmjet vetë zonave rurale të jenë më të lehta. Për këtë arsye, Komuna e Rahovecit do të investojë në rrugë lokale që lidhin fshatra apo lagje të ndryshme, ku është e nevojshme. Përmes këtij investimi, lirohen nga ngarkesa edhe rrugët kryesore që shpiten në qytet ose vendbanime të mëdha;

- Mirëmbajtje e gropave ekzistuese septike, dhe ndërtimi i gropave të reja septike;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj;
- Bashkëpunim me KRU GJAKOVA dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Ndërtimi i shtigjeve për biçiklistë në zonën urbane dhe periferike;
- Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta;
- Trajtimi i ujërave të zeza dhe i rrugëve në pjesë problematike të Qytetit;
- Menaxhimi i integruar i mbeturinave dhe riciklimi i tyre;

2. Administratë e Përgjithshme

- Komunë e hapur për qytetarët - transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë ku u shërbehet qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Transparencë për qytetarë – Komuna e Rahovecit do të përkushtohet në rritjen e transparencës përmes aplikimit të metodave të reja të komunikimit online për qytetarë dhe medie;
- Shërbimet komunale janë të rëndësishme për qytetarët, prandaj Komuna e Rahovecit do të investojë në vazhdimësi në modernizimin dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e zyrave komunale/gjendjes civile;
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile;
- Funkcionalizimi i sporteleve të veçanta për mërgatën;
- Më shumë pajisje digjitale (E-KIOSK) për ofrimin e sa më shumë shërbimeve për qytetarët;
- Zbatimi i të gjitha planeve komunale;
- Buxhetimi gjinor.

3. Rinia, kultura dhe sporti

- Përkrahje e të rinjve, shoqatave kulturo-artistike dhe klubeve sportive;
- Subvencionimi i projekteve - Do të vazhdojë subvencionimi i projekteve kulturo-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Përfundimi i Qendrës për Arte, Kulturë dhe Inovacion – Komuna e Rahovecit do ta përfundojë Qendrën për Arte, Kulturë dhe Inovacion, e cila do të jetë një hapësirë që do të përmbushë nevojat e komunitetit artistik dhe të të rinjve në fushën e artit, kulturës dhe inovacionit;
- Fusha sportive në çdo fshat dhe lagje;
- Trashëgimia kulturore dhe historike – Komuna do të vazhdojë të kujdeset për objektet e trashëgimisë kulturore, duke mirëmbajtur infrastrukturën e tyre dhe përreth tyre, por edhe do të krijojë atraksione turistike nga to;
- Përfshirja e objekteve të rëndësishme të veçantë në listën e monumenteve që janë nën përkujdesje institucionale;

- Muzetë, komplekset përkujtimore, bustet dhe shtatoret – Me qëllim të ruajtjes së të kaluarës historike, do të ketë përkujdesje të veçantë, si dhe do të themelohen muze dhe komplekse të reja përkujtimore, në bashkëpunim me komunitetin dhe historianët lokalë. Po ashtu, do të mirëmbahen shtatoret dhe bustet ekzistuese të dëshmorëve, por në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta do të realizohen edhe shtatore dhe buste të reja, për t'i nderuar të rënë për liri;
- Rritje e përkrahjes për festivalet tradicionale dhe e ngjarjeve të tjera të shënuara për afirmimin e vlerave kulturore, të trashëgimisë historike dhe të turizmit;
- Themelimi dhe funksionalizimi i Ansambllit Profesional të Këngëve dhe të Valleve të Rahovecit;
- Qendra inovative funksionale për të rinjtë;
- Kompleksi sportiv tek EPOPEJA E UÇK-së mbi Rahovec;
- Stadiumi i Qytetit të Rahovecit dhe stadiumet e tjera;
- Mbështetje rinisë për ide kreative dhe artistike;
- Mbështetja e të gjitha klubeve dhe shkollave sportive etj.
- Trajtimi dhe mirëmbajtja e palestrave të sporteve, fushave sportive dhe ndërtimi i terreneve të reja sportive dhe objekteve kulturore;
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë dhe mbështetje për projektet e OJQ-ve të cilat veprojnë në komunën tonë;
- Intervenimi dhe restaurimi në monumentet kulturo-historike dhe mirëmbajtja e tyre;
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e komunës sonë;
- Krijimi i hapësirave për biblioteka në vendbanimet e komunës së Rahovecit (aty ku ka hapësira).
- Hartimi i strategjisë për rini.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Indikatorët ekonomik komunal

Ndonëse komuna nuk udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me Kornizën Makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike, siç janë: Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës, bazuar në të dhënat historike, si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2024-2026, ku parashihet një rritje reale vjetore, 4.10 % në vitin 2023, ndërsa rritja reale e Bruto produktit të vendit në 2024 - 2026 parashihet të jetë 4.20%, respektivisht 3.90%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në komunë, që në periudhën afatmesme ulet me **1.45 %**, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj, do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht, financimi komunal përfshin: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grandet qeveritare**. Komunitat po ashtu janë pranuese të granteve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshëm (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2024-2026, nëse krijohen rrethanat, planifikon të marrë hua nga institucionet financiare për të financuar projektet e saj në projektet për menaxhimin e ujërave të zeza, eventualisht ndonjë projekt tjetër me rëndësi strategjike për komunën tonë, për të cilën hua garantuese do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomikë komunalë


Përshkrimi	2023	2024	2025 (vlerësimet)	2026 (vlerësimet)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	3.5	3.9	3.9	3.60
Inflacioni në %	5.50	2.60	2.30	2.00
BPV për kokë banori, në euro	9.832	10.871	11.241	11.894
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2.602	1.845	1.656	1.458
Numri i nxënësve	9.012	8,298	8,015	7,729

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2024-2026

3.2. Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2024-2026

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grandet qeveritare, si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Paraqitja grafike 1: Buxheti Total i Komunës në vitet (2024 – 2026), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2023, grandet qeveritare për Komunën e Rahovecit ,si tërësi, do të shënojnë rritje prej **14,89%** në vitin 2024. Rritja e Grandit Qeveritar do të jetë **5.04%** në vitin 2025, në krahasim me 2024, ndërsa të hyrat vetanake në vitin 2024 do të kenë një rritje prej: **11.71%** në krahasim me 2023.

Nga viti 2024-2026 parashihet një rritje prej **14.17 %** në tërësi, sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 2 më poshtë, në Grandin qeveritar parashihet të ketë rritje prej **14.39 %** ndërsa në të hyrat vetanake **11,73 %** kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nacionale, siç parashihet me qarkoren 2024/01 (KASH 2024-2026).

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2024-2026, në Euro

Burimi i të hyrave	2023	2024	2025	2026
Plani	1,445,603.00	1,614,904.00	1,677,349.00	1,760,591.00
Buxhet dhe Financa	880,514.00	978,419.00	1,021,704.00	1,056,841.00
Tatimi në Pronë	423,250.00	431,715.00	440,000.00	470,000.00
Taksa nga Mbeturina	0.00	170,000.00	200,000.00	200,000.00
Tatimi në Tokë	367,264.00	276,704.00	281,704.00	286,841.00
Taksat rrugore	90,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00
Administrata dhe Personeli	118,589.00	115,200.00	117,000.00	124,000.00
Taksa Certifikatat e lindjes	14,000.00	14,000.00	15,000.00	16,000.00
Taksa Certifikatat e kurorëzimit	8,000.00	9,000.00	9,000.00	10,000.00
Taksa Certifikatat e vdekjes	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Taksa Certifikatat tjera ofiçarie	45,389.00	45,000.00	45,000.00	46,000.00
Takse për pjesëmarrje ne tender	200.00	200.00	0.00	0.00
Taksë për verifikimin e dokumenteve	5,000.00	4,000.00	5,000.00	6,000.00
Taksa të tjera administrative	44,000.00	41,000.00	41,000.00	44,000.00
Inspekcioni	6,500.00	11,300.00	13,560.00	14,000.00
Taksa të tjera administrative	0.00	300.00	360.00	200.00
Gjobat nga inspektoriat	5,000.00	10,000.00	11,700.00	12,000.00
Licencë për pranimin e lokalit	1,000.00	1,000.00	1,500.00	1,700.00
Inspektimi higjienik dhe sanitar	500.00	0.00	0.00	0.00
Shërbime Publike	10,800.00	12,700.00	14,000.00	10,600.00
Taksa për leje gjermime	1,000.00	1,500.00	2,000.00	2,500.00
Të hyrat nga shitja e mbeturinave	0.00	0.00	0.00	0.00
Shfrytëzimi i pronës publike	3,000.00	2,000.00	2,500.00	2,500.00
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	3,000.00	5,000.00	5,000.00	500.00
Qiraja nga objektet publike	3,000.00	3,200.00	3,500.00	4,000.00
Licenca të lira individuale	300.00	500.00	600.00	600.00
Largimi dhe deponimi i automjeteve	500.00	500.00	600.00	500.00
Bujqësia dhe zhvillimi rural	44,000.00	36,700.00	28,500.00	32,500.00
Taksa të tjera administrative	0.00	500.00	1,000.00	1,000.00
Taksa -të hyrat nga pyjet	0.00	200.00	500.00	500.00
Shfrytëzimi i pronës publike (qiraja e tokës bujqësore)	1,000.00	5,000.00	6,000.00	10,000.00
Participimet në bujqësi	42,000.00	30,000.00	20,000.00	20,000.00
Taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Ekonomia dhe Zhvillimi	157,000.00	210,135.00	208,850.00	224,000.00
Licenca të lira individuale	0.00	0.00	0.00	0.00
Licenca për shërbime profesionale	0.00	50.00	150.00	200.00
Taksë për ushtrimin e veprimtarisë	75,000.00	106,863.00	106,000.00	105,000.00
Licenca tjera per afarizem	0.00	450.00	700.00	800.00

Qiraja nga vendosja e objektit tregtar	82,000.00	102,7720.00	102,000.00	118,000.00
Kadastër dhe Gjeodezia	55,000.00	77,000.00	76,000.00	79,500.00
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë	30,000.00	32,000.00	33,000.00	36,000.00
Taksa e tjera administrative	0.00	2.000.00	3.000.00	1.500.00
Taksa per fl. Posed. dhe kopje plani	0.00	15.000.00	15.000.00	12.000.00
Taksa për matjen e tokës në terren	25,000.00	28,000.00	25,000.00	30,000.00
Urbanizmi	68,000.00	64,000.00	77,085.00	91,000.00
Taksa komunale për leje ndërtimi	36,000.00	45,000.00	53,085.00	65,000.00
Taksa të tjera administrative	0.00	6.000.00	6.000.00	6.000.00
Taksa për demolim	1.000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Taksa për legalizimin e objekteve	21,000.00	0.00	0.00	0.00
Inspektimi respektimi i planit urbanistik	2.000.00	2,000.00	3,000.00	3,000.00
Leje mjedisore komunale	8,000.00	10,000.00	14,000.00	16,000.00
Shëndetësia dhe mirëqenienie sociale	80,000.00	74,450.00	79,450.00	84,450.00
Participimi nga shëndetësia	80,000.00	70,000.00	75,000.00	80,000.00
Taksa të tjera administrative	0.00	450.00	450.00	450.00
Taksa per verifikimin e dok. Te ndryshme	0.00	4.000.00	4.000.00	4.000.00
Kulturë, Rini, Sport	3,000.00	4,800.00	8,000.00	8,500.00
Shitja e shërbimeve (biblioteka)	1,000.00	4,800.00	8,000.00	8,500.00
Arsimi dhe Shkencë	22,200.00	30,200.00	33,200.00	35,200.00
Participimet - çerdhja e femijëve	22,000.00	30,200.00	33,200.00	35,200.00
Participimi në arsim	200.00	0.00	0.00	0.00

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1. Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorët e jashtëm gjatë vitit 2024-2026, presim qe te kemi donacione,dhe financim nga performanca.

3.2.2. Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adaptimit të politikave të reja që ka iniciuar Qeveria e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të iniciuara në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2024-2026, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shumta e Grandit të Përgjithshëm të Komunave që aktualisht është dhjetë përqindja (10%) e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë Qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 9%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2024 dhe 2026 në Kornizën

Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende në këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe duke menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grandit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grandit të arsimit për komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ul grandin e arsimit, sidomos duhet pasur parasysh se ky grand përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk i ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, komuna e Rahovecit ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Nationale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Grandi i Përgjithshëm si shtesë, përveçse nga të hyrat vetanake komunale.

Ndërsa, sa u përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish Qeveria Nationale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes, eventualisht eliminimit të atyre taksave e ngarkesave komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal. Edhe në të ardhmen barra kryesore në realizimin e të hyrave vetanake bie mbi tatimin në pronë dhe në tatimin në tokë.

3.3. Tendencia e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2024-2026

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2024/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2024, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 do t'i paraqesim sipas kategorive ekonomike:

• Pagat dhe Mëditjet	10.300.983.00
• Mallrat dhe Shërbimet	2.466.340.00
• Shpenzimet Komunale	370.000.00
• Subvencionet dhe Transferet	890.000.00
• Shpenzimet Kapitale	6.007.462.00
TOTAL	20.034.785.00

3.3.1. Pagat dhe Mëditjet

Gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin 2023, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet **14.17 %** si rezultat i ligjit të pagave. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe e mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **51.42%**.

3.3.2. Mallrat dhe Shërbimet

Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitë), është rritur për **11.03 %** nga viti 2023 në vitin 2024, për arsye të rritjes së buxhetit, dhe për ikur keqklasifikimit, disa nga projektet të cilat kanë qenë të planifikuara në kuadër të investimeve kapitale, tani janë të planifikuara në kuadër të Mallrave dhe shërbime kryesisht projektet me karakter mirëmbajtje. Andaj pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë vitit 2024 pritet të jetë mesatarisht **14.16 %**.

3.3.3. Subvencionet

Në vitin 2024 komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, ekonomi, shëndetësi, arsim, kulturë, rini dhe sport, dhe në kuadër të shërbimeve publike. Gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet për **8.54 %**. Gjithashtu edhe kjo kategori e buxhetit, për të larguar keqklasifikimin e mundshëm, disa nga projektet të cilat kanë qenë të planifikuara në kuadër të investimeve kapitale, tani janë të planifikuara në kuadër të Subvencioneve. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë vitit 2024 mesatarisht do të jetë **4.44 %**.

3.3.4. Investimet Kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2024, për **5.76 %** krahasuar me vitin 2023. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2023 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: **29.99 %**.




Tabela 3: Korniza Buxhetore Komunale 2024-2026, në euro.

	Përshkrimi	2023	2024	2025	2026
			(plan)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	17,548,240.00	20,034,785.00	21,044,790.00	22,079,911.00
	Të hyrat vetanake	1,445,603.00	1,614,904.00	1,677,349.00	1,760,591.00
	Grandet dhe transferet qeveritare	16,102,637.00	18,419,881.00	19,367,441.00	20,319,320.00
2	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	17,548,240.00	20,034,785.00	21,044,790.00	22,079,911.00
	Shpenzimet rrjedhëse	11,896,917.00	14,027,323.00	14,632,633.00	15,346,832.00
	Pagat dhe mëditjet	8,503,088.00	10,300,983.00	10,816,032.00	11,356,832.00
	Mallrat dhe shërbimet	2,203,829.00	2,466,340.00	2,506,341.00	2,650,000.00
	Shpenzimet komunale	370,000.00	370,000.00	400,000.00	400,000.00
	Subvencionet	820,000.00	890,000.00	890,000.00	940,000.00
3	Shpenzimet Kapitale	5,651,323.00	6,007,462.00	6,412,417.00	6,733,079.00
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve në komunë në bazë të programeve apo kategorive funksionale, si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 4) janë ato aktuale të vitit 2023, planifikimi për vitin 2024-2026, si dhe projeksionet e përgatitjes (Tabela 4-5-6-7).

Tabela 4: Shpenzimet në vitin 2023, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	178,520	55,000		160,000		393,520
Administrata	217,362	175,830			28,000	421,192
Çështjet Gjimore	5,308	2,000				7,308
Inspektimet	71,454	15,000				86,454
Zyra e Kuvendit Komunal	107,126	17,000				124,126
Buxhet dhe Financa	100,202	250,000			279,000	629,202
Shërbime publike	27,650	495,000	216,000		970,000	1,708,650
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	149,328	15,000			0	164,328
Zyra Lokale për Komunitete	58,850	15,000			20,000	93,850
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	65,162	60,000		440,000	1,005,000	1,570,162
Zhvillimi Ekonomik	43,928	17,000		20,000	158,000	238,928
Kadastri dhe Gjeodezia	64,368	16,000			0	80,368
Planifikimi Urban dhe Mjedis	40,754	180,000			1,400,000	1,620,754
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,851,357	350,000	80,000	90,000	244,363	2,615,720
Qendra për punë Sociale	101,284	10,000	4,000			115,284
Kulturë, Rini, Sport	67,370	50,000		110,000	505,351	732,721
Administrata e Arsimit	53,820	55,000			20,000	128,820
Arsimi Parafillor	167,137	75,000	8,500		90,000	340,637
Arsimi Fillor	4,311,155	193,237	46,500		580,000	5,130,892
Arsimi Mesëm	1,208,728	57,278	15,000			1,281,006
TOTAL	8,890,863	2,103,345	370,000	820,000	5,299,714	17,483,922

Tabela 5: Shpenzimet për 2024, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	189,139.00	55,000.00		230,000.00	-	474,139.00
Administrata	238,906.00	148,000.00			25,000.00	411,906.00
Çështjet Gjinore	5,265.00	2,000.00			-	7,265.00
Inspektimet	111,165.00	60,000.00			-	171,165.00
Zyra e Kuvendit Komunal	292,118.00	17,000.00			-	309,118.00
Buxhet dhe Financa	109,114.00	200,000.00			220,000.00	529,114.00
Shërbime publike	31,804.00	605,000.00	216,000.00		1,246,120.00	2,098,924.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	166,690.00	15,000.00			-	171,690.00
Zyra Lokale për Komunitete	100,862.00	15,000.00			30,000.00	145,862.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	77,098.00	90,000.00		440,000.00	1,160,000.00	1,767,098.00
Zhvillimi Ekonomik	53,031.00	20,000.00		20,000.00	70,000.00	163,031.00
Kadastra dhe Gjeodezia	74,666.00	16,000.00			-	90,666.00
Planifikimi Urban dhe Mjedis	52,206.00	320,000.00			1,730,000.00	2,102,206.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	1,956,630.00	350,000.00	80,000.00	90,000.00	266,204.00	2,742,834.00
Qendra për punë Sociale	108,530.00	10,000.00	4,000.00		-	122,530.00
Kulturë, Rini, Sport	92,444.00	70,000.00		110,000.00	660,138.00	932,582.00
Administrata e Arsimit	66,104.00	55,000.00			600,000.00	721,104.00
Arsimi Parafillor	220,667.00	87,000.00	8,500.00			316,167.00
Arsimi Fillor	5,119,432.00	233,237.00	46,500.00		-	5,399,169.00
Arsimi Mesem	1,245,112.00	98,103.00	15,000.00		-	1,358,215.00
TOTAL	10,300,983.00	2,466,340.00	370,000.00	890,000.00	6,007,462.00	20,034,785.00

Tabela 6: Shpenzimet, projeksionet 2025, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	198,596.00	55,000.00		200,000.00	0.00	453,596.00
Administrata	250,851.00	148,000.00			0.00	398,851.00
Çështjet Gjimore	5,528.00	2,000.00			0.00	7,528.00
Inspektimet	116,723.00	60,000.00			0.00	176,723.00
Zyra e Kuvendit Komunal	306,724.00	17,000.00			0.00	323,724.00
Buxhet dhe Financa	114,570.00	200,000.00			103,524.00	418,094.00
Shërbime publike	33,394.00	645,001.00	246,000.00	50,000.00	1,068,651.00	2,043,046.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	164,524.00	15,000.00			0.00	179,524.00
Zyra Lokale për Komunitete	105,905.00	15,000.00			20,000.00	140,905.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	80,953.00	90,000.00		440,000.00	1,360,000.00	1,970,953.00
Zhvillimi Ekonomik	55,682.00	20,000.00		20,000.00	70,242.00	165,924.00
Kadastra dhe Gjeodezia	78,399.00	16,000.00			0.00	94,399.00
Planifikimi Urban dhe Mjedesi	54,816.00	320,000.00		0.00	2,130,000.00	2,504,816.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	2,054,461.00	350,000.00	80,000.00	90,000.00	300,000.00	2,874,461.00
Qendra për punë Sociale	113,956.00	10,000.00	4,000.00		0.00	127,956.00
Kulturë, Rini, Sport	97,066.00	70,000.00		110,000.00	580,000.00	857,066.00
Administrata e Arsimit	69,409.00	55,000.00			780,000.00	904,409.00
Arsimi Parafillor	229,690.00	87,000.00	8,500.00			325,190.00
Arsimi Fillor	5,373,904.00	233,237.00	46,500.00		0.00	5,653,641.00
Arsimi Mesem	1,310,881.00	98,103.00	15,000.00			1,423,984.00
TOTAL	10,816,032.00	2,506,341.00	400,000.00	910,000.00	6,412,417.00	21,044,790.00

Tabela 7: Shpenzimet, projeksionet 2026, të shpërndara në kategori ekonomike në programe dhe nën programe:

Programe	Paga	Mallra dhe shërbime	Shërbime komunale	Subvencion e	Investime Kapitale	Totali
Zyra e Kryetarit	208,526.00	55,000.00		220,000.00	0.00	483,526.00
Administrata	263,394.00	148,000.00			0.00	411,394.00
Çështjet Gjimore	5,805.00	2,000.00			0.00	7,805.00
Inspektimet	122,599.00	60,000.00			0.00	182,599.00
Zyra e Kuvendit Komunal	322,060.00	17,000.00			0.00	339,060.00
Buxhet dhe Financa	120,298.00	200,000.00			200,000.00	520,298.00
Shërbime publike	35,064.00	695,001.00	246,000.00	50,000.00	1,500,000.00	2,526,065.00
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	172,750.00	15,000.00			0.00	187,750.00
Zyra Lokale për Komunitete	111,200.00	15,000.00			0.00	126,200.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillim	85,001.00	90,000.00		450,000.00	600,000.00	1,225,001.00
Zhvillimi Ekonomik	58,467.00	20,000.00		20,000.00	0.00	98,467.00
Kadastra dhe Gjeodezia	82,319.00	16,000.00			0.00	98,319.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	57,557.00	413,659.00		0.00	860,000.00	1,331,216.00
Shëndetësia dhe Mirëqenie Sociale	2,157,148.00	350,000.00	80,000.00	90,000.00	370,000.00	3,047,148.00
Qendra për punë Sociale	119,920.00	10,000.00	4,000.00		0.00	133,920.00
Kulturë, Rini, Sport	101,920.00	70,000.00		110,000.00	2,083,078.00	2,364,998.00
Administrata e Arsimit	72,880.00	55,000.00			1,120,000.00	1,247,880.00
Arsimi Parafillor	243,729.00	87,000.00	8,500.00			339,229.00
Arsimi Fillor	5,646,099.00	233,237.00	46,500.00		0.00	5,925,836.00
Arsimi Mesëm	1,370,096.00	98,103.00	15,000.00			1,483,199.00
TOTAL	11,356,832.00	2,650,000.00	400,000.00	940,000.00	6,733,078.00	22,079,910.00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më lart, paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës, e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst, përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

3.4. Analiza Gjimore-Buxhetimi Gjimore

Komuna ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjimore të detajuar, por jemi përpjekur të vlerësojmë se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe të burrave, të djemve dhe të vajzave të punësuar në kuadër të komunës (Administratë, Shëndetsi dhe Arsim), si dhe kemi bërë një analizë të hollësishme të numrit të banorëve në proporcion të burrave dhe grave. Andaj, kemi nxjerrë të dhëna të pjesëmarrjes së gjinisë femërore në kategorinë buxhetore për Mallra dhe Shërbime si dhe Investime Kapitale (shih tabelën nr. 4).

Ndërsa në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve për gjininë femërore planifikojmë të buxhetojmë për vitin 2024-2026 (shih tabelën nr. 4).

Sqarim: Tabela e mëposhtme bazohet në shifrat që janë sipas listës së Pagave dhe Mëditjeve, të qershorit 2023 dhe numrin aktual të të punësuarve.

Tabela : Struktura e të punësuarve sipas gjinisë

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Komunë

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit - gra	Numri i stafit - burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2020	1186	437	749	2,607,464.28	4,399,946.88
2021	1186	476	710	1,413,872.58	2,146,315.82
2022	1184	441	743	2,949,906.84	4,143,442.92
Planifikimi 2023	1184	441	743		

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2024 - Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore

Niveli i pagave	Numri i total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	55	26	9,564.19	29	9,589.61
401-600	451	223	109,871.74	228	125,991.11
600+	660	415	292,838.07	245	157,019.11

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve, të shërbimeve të ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri total i përfituesve -i grave	Numri total i përfituesve për burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2020	320,532.48	635	251	384	112,186.37	208,186.00
2021	311,000.00	1156	478	678	144,325.94	332,874.06
2022	342,703.91	651	363	288	165,791.38	176,912.53
Planifikimi 2023	820,000.00					

Tabela 4. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor sipas kategorive ekonomike 2024-2026

Viti	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Subvencione	Investime Kapitale
2024	3,836,086.06	1,215,165.72	45,000.00	2,959,876.52
2025	4,027,890.31	1,234,874.21	50,000.00	3,159,397.85
2026	4,229,284.23	1,305,655	55,000.00	3,317,387.53

Në tabelën nr.4 është i përfshirë buxheti i përgjithshëm për gjininë femërore si dhe projeksionet 2025-2026. Në pozicionin paga dhe mëditje është e përfshirë gjinia femërore, të cilat janë të punësuar në kuadër të Komunës, duke përfshirë administratën, shëndetësinë dhe arsimin, ku nga numri i përgjithshëm i të punësuarve prej 1184, 441 prej tyre janë të gjinisë femërore ose më saktë 37,24% me pjesëmarrje në paga dhe mëditje.

Ne kategorinë Mallra dhe Shërbime, të dhënat janë nxjerrur nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Komunës së Rahovecit prej 56,208 banorë, ku prej tyre të gjinisë femërore janë 27,696 ose 49,27%.

Në kategorinë Investime Kapitale të dhënat po ashtu janë nxjerrur nga numri i përgjithshëm i popullsisë së Komunës së Rahovecit prej 56,208 banorë, ku prej tyre të gjinisë femërore janë 27,696 ose 49,27%.

Ndërsa në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve planifikojmë ta buxhetojmë në këtë mënyrë, sipas viteve:

2024 në shumën: 45,000.00 €

2025 në shumën: 50,000.00 €

2026 në shumë: 55,000.00 €

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Kryetari





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.5.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:35**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **zt. Smajl Latifi**, Nënkyetar **zt. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e pestë (5) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 19 maj, për këtë seancë, ka përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore 2024/1;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P- 7151057-02240-1, në zonën kadastrale – Rahovec;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme P-71510052-00363-0, zona kadastrale - Mrasor;

Shtesë: Shfuqizimi i vendimit Nr.62/2023 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në 2023;

Kryesuesi - Arsyeja e shfuqizimi të pikës shtesë është sepse Ministria e Financave ka marrë një vendim tjetër për zhbllokimin e mjeteve të komunave dhe rrjedhimisht ky vendim duhet të shfuqizohet nga kuvendi i komunës, që në seancën tjetër ta votojmë një vendim tjetër.

A ka dikush ndonjë koment rreth rendit të ditës për seancën e sotme?... Apo ndonjë koment për pikën shtesë?... Nëse jo, atëherë kush është “për” vendosjen e kësaj pike shtesë në rend të ditës?... Me shumicë votash, rendit të ditës i shtohet edhe pika e dhjetë. Po e vendosim në votim për miratim edhe rendin e ditës, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për seancën e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet procesverbali i seancës së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Vlora Vuçiterna Çmega – Përshëndetje për të gjithë! Nënkrytar, po ju drejtohem juve meqenëse kryetari momentalisht nuk është këtu i pranishëm. Çka po ndodh në konkurset që po i shpallni nëpër sektorë të ndryshëm?... Në konkurset e drejtimeve farmaci, infermieri apo edhe stomatologji, kandidatët me numër maksimal të pikëve janë familjarë të ndonjërit nga ju. Para një viti e kam parashtruar pyetjen se a do të ketë shpresë edhe për kandidatët e tjerë që të pranohen në këtë pozita! Përgjigjen e kam ditur, por pyetjen e kam bërë qëllimisht që të vetëdijesohet edhe një pjesë tjetër e banorëve të cilët kanë pasur sado pak dyshim në këtë aspekt dhe me ndodhitë e konkurseve të fundit, janë bindur plotësisht. Me bindje të plotë po e them se kjo që ka ndodhur është një ndër skandalet më të mëdha të juaja.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! I nderuar ekzekutiv, të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit të komunës. Reagimi im ka të bëjë rreth një tenderi dhe që është anuluar kontrata e akvitetit të prokurimit. Operatori ekonomik i cili e ka fituar këtë tender, dyshohet që i ka përcaktuar çmimet vet, gjë që është shkelje ligjore. Neni 65 i ligjit të prokurimit thotë: Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në aktivitetet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike që shfrytëzohen nga autoritetet përkatëse kontraktuese. Sipas këtij neni, prokurimi ka bërë shkelje ligjore dhe ky keqadministrim i buxhetit është në dëm të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Doja të ndërlihem edhe me aktivitetin që është duke e ndërmarrë Komuna e Rahovecit në rregullimin e rrugëve fushore, sipas njoftimit në faqen e Komunës, ka filluar mirëmbajtja dhe rregullimi i rrugëve fushore dhe a do të vazhdojë edhe në rajonet e atyre që kanë bërë kërkesa.

Edonë Kryeziu - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Faleminderit i nderuar kryesues. Gjatë kontakteve të vazhdueshme që kam me qytetarët e fshatit Xërxë, në pyetjen time dua t'i dëgjoj disa opinione nga ana e kryetarit dhe e drejtorisë së Shëndetësisë. QMF-ja mungon vetëm në fshatin Xërxë, përkundër bashkësive lokale tjera. Kërkojmë që AMF-ja e fshatit tonë të shndërrohet në QMF. Udhëzimet administrative të këtyre sektorëve i kemi lexuar me shumë vëmendje dhe një veprim i tillë i takon fshatit Xërxë, duke e ditur pozitën gjeografike, numrin e banorëve, fluksin e banorëve, ka pak emigrim dhe poashtu ka biznese e shumta. Kryetar, a e dini sa maltretim është që një pacient i sëmurë ta kryej shërbimin në Xërxë, ndërsa vulën në Rahovec! Kur i pyesim punëtorët, pse ky maltretim, ata përgjigje: Sepse e kemi statusin AMF. Poashtu, mantilbardhët detyrohen edhe ta pastrojnë ambientin e AMF-së, sepse pastrueset punojnë një herë në javë! A është e mjaftueshme mirëmbajtja vetëm një orë gjatë javës?... Në fund, qfarë po ndodh me rrogat jubilarë të punëtorëve të këtij sektori dhe pse duhet që çdo herë ta marrin atë përmes proceseve gjyqësore, duke u bërë rutinë që proceset gjyqësore t'i fitojë pala dhe asnjëherë komuna.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, drejtorë, kolegë asambleistë, media. E kam një shqetësim që ka ndodhur mbrëmë në Krushë të Madhe, është djegur pushimorja apo objekti i Feim Durakut. Ftojme prokurorinë për hetim, ta ndriçojnë këtë rast sepse kjo i zbeh edhe investitorët potencial në atë anë. Tjetra, janë dy rrugë fushore në gjendje shumë të keqe, mirë është të zgjidhet. Kemi nevojë edhe për një fushë të sportit sepse kemi presion nga komuniteti.

Ilir Pallqa – Faleminderit! I nderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë, të pranishëm. Të dashur banorë të Komunës së Rahovecit! Jemi në Pranverë, moti po ndryshon për të mirë – vetëm moti. Në Rahovec po punohet kryesisht në bujqësi – punë që na nderon. Rinia po ik kryesisht në perëndim – kjo na bënë fajtorë. Largimi është dorëzim, nuk është mirë të ikim, por fatkeqësisht nuk ka argumente të mjaftueshme sa të arsyetohet qëndrimi me çdo

kusht, sepse pas çdo arsyetimi tim ka dhjetra arsye nga ana tjetër për mosqëndrim! Prapë mendoj që duhet të qëndrojmë, të rezistojmë, të flasim, e të veprojmë kundërdrejt çdo të keqe që i bëhet shoqërisë sonë. Në fund të fundit, ndryshimi arrihet duke u nisë nga individit e më pas nga shoqëria. Arsyet janë të ndryshme, ata që kanë vendosur, kanë vendosur. Ata që janë në dyshim, duhet të qëndrojnë, por nëse ne vazhdojmë kështu (ose më saktë, nëse ju vazhdoni kështu) nuk do të qëndrojnë as këta. Komuna jonë ndoshta është e vetmja komunë që nuk ka qytet, për nga forma veçohet që është fshati më i madh në Kosovë. Prej Majës së Shkodranit, kur i kthejmë sytë në ndërtim, e shohim ngjyrën e kuqe (tjegullat e kuqe, përgjithësisht kuq). Kur kthehemi në rrafsh, shohim çrregullime, vjetërsira të shëmtuara dhe rrugë të shkatërruara. E gjithë kjo, si pasojë e udhëheqësve në komunë. Te ne, aktualisht po udhëheq një njeri me emocione të hargjuara për Rahovec. Kryetari ynë po udhëheq pa plan dhe pa vizion, po udhëheq sipas planeve të shokëve të tij, të shokëve biznesmen, të cilët prioritet e kanë pasurimin personal dhe të fundit e kanë interesin publik. Po udhëheq duhe rahatuar njerëz partiak e familjarë nëpër institucione publike. Po udhëheq me fjalime të rjedhshme e me punë të kufizuar rreth interesave të ngushta të AAK-së. Ne po heshtim! Rinia kërkon një mjedis pune ku ka meritokraci, e ku ka sfida për ta arritur qëllimin. Po heshtim kur shohim vit pas viti ndarje të mjeteve bujqësore, kjo është mirë, por të bëhet me masë dhe me hak. Rinia kërkon projekte interesante dhe inovative për angazhim personal. Po heshtim kur shohim ndërtime pa leje, rinia kërkon rekreacion! Nuk duhet të heshtim, duhet të qëndrojmë, të flasim dhe të veprojmë.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, zv.kryetar, drejtorë, kolegë, media. Një pyetje rreth rrugës “Sheh Myhedini”! Në këtë kohë nuk ka fare punime edhe pse jemi në një fazë kur mirëpritën mërgimtarët! Mirëpo, nëse kjo rrugë nuk rregullohet pritet të kemi një ngulfatje të komunikacionit. A kemi shpresë që sa më shpejt të rregullohet?

Eqrem Spahiu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. I kam dy pyetje: Punimet në zonën ekonomike kanë filluar gati që një muaj, në hyrje të fshatit të ketë një hyrje të veçantë për shkaqe sigurie. E dyta: Ne si komision i stacionit të autobusëve jemi pa mjete që një vit, kur do të bëhet kompenzimi?...

Merisa Sharku – Përshëndetje për të gjithë! Pyetjet e mia vinë rrjedhimisht pas këtij kaosi të madh në qytetin e Rahovecit, kap një, le tjetrën. Kur përfundon sheshi në qendër të qytetit?... Kur përfundon rruga në qendër, ku është bërë devijimi i lumit? Kur përfundon sheshi i republikës dhe rruga “Ali Sokoli” e cila po gropohet dy herë brenda muajit!

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, përfaqësues të KFOR-it, media, kolegë asambleistë. Befasohem pse bëhet gjithë këto pyetje rreth projekteve, kur kemi një ekzekutiv totalisht të paaftë për menaxhim të projekteve. Ky ekzekutiv nuk dinë të bëjë projekte zhvillimore, koha është duke e dëshmuar me të gjitha projektet në gjysëm, me ngulfatje totale dhe pa vizion. Rreth tenderit për furnizim për QKMF-në: Kompania e cila e ka bërë paramasën, e ka fituar tenderin. Tenderi është anuluar duke ndërhyrë OSHP-ja. A nënkupton kjo që më herët kanë ndodhur shumë projekte ksisoj? Te ky projekt, a është marrë ndonjë veprim ndaj personit përgjegjës i cili ka lejuar që kompania e njejtë ta fitojë tenderin dhe ta bëjë paramasën. Ju si kryetar komune, a keni marrë veprim rreth personit përgjegjës? Apo solidarizoheni me të sepse e ka bërë për ju. Momenti që nuk ka veprim, nënkupton që je vet i involvuar, në të kundërtën, veprohet ndaj personave që bëjnë shkelje logjore, sepse kjo është publikisht kurdije e tenderit. Prej drejtorit të financave morëm një informatë rreth borxheve dhe obligimeve: Te pjesa përmbartimore e kemi një vlerë prej 75.000€ që komuna e Rahovecit i ka humbur për vitin 2022 dhe fillimin e 2023-tës. Në procedurë të avokatit dhe për përmbartuesin janë rreth 400.000€ që janë marrë brenda dy viteve (raport zyrtar prej drejtorisë së Financave). I kemi rreth 2.5 milion që presin t’i marrin arsimtarët, gjithashtu edhe kjo është çështje e humbur, duke marrë parasysh që shkollat vazhdimisht po i marrin. Te obligimet: Ndërtimi i shkollës fillore të mesme të ulët, “Liria” në Fortesë, nuk janë edhe 7 muaj sepse kontrata është lidhur në 2019, ka përfunduar dhe borxhi është edhe 45.000€. I kemi edhe 14 projekte tjera me afat kohor të përfundur dhe kanë borxhe të mbetura. Sipas raportit të drejtorisë së Financave 15.453.683.06€ janë obligime dhe borxhe. Është edhe servisimi edhe mirëmbajtja e kabinetit të radiologjisë diku rreth 96.000€ kontratë (borxhi 88.660€) e lidhur në 2023, kur ia shtojmë edhe 2-3 milion te disa projekte tjera i bie që Komuna e Rahovecit sot është në obligime 20 milion dhe jo 15 milion, sepse kontratat e vitit 2023 nuk janë të përfshiera në raport. Nëse e keni problem zgjidhjen në punët përmbartimore, pyeteni Sinanin, ju këshillon në këtë punë. Kryetar, cilat janë masat tua të ndërmarra rreth personave përgjegjës që kanë lejuar që e njëjta kompani ta bëjë paramasën dhe e njëjta ta fitojë tenderin?!

Drilon Mustafa – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kabinet i qeverisë Latifi, të nderuar kolegë. Kam një pyetje për drejtorinë e Arsimit: Sa shkolla do të pajisen me mjete laboratorike në kontratën që është lidhur ditëve të fundit?... Një shtetësim tjetër që qytetarëve në lidhje me ujitjen e asfaltit që bëhet. A mund të nxerret ndonjë udhëzim administrativ apo a ekziston ndonjë udhëzim administrativ që e ndalon këtë çështje! Shqetësimi tjetër ka të bëjë me loston e lartë të mirëmbajtjes së kanalizimit. Kërkojë që vlera për mirëmbajtje të zbritet. Opozitës i sugjeroj të punojnë në pozitivisht sepse mendimi negativ e sjell vesin, vesi e krijon karakterin dhe karakteri e përcakton të ardhmen! Qytetarët e dinë që me këto mendime, nuk kanë të ardhme me ju!

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kryesues, nënkryetar, kolegë, drejtorë. E kam një sugjerim për opozitën, të koordinohen më shumë në mes vete. Te pyetjet e bëra në diskutime thanë që “asgjë s’po punoni”, gjatë diskutimeve u përmendën 7-8 projekte në qytet që janë në punime e sipër! Koordinohuni më mirë, se jemi duke dalur keq para qytetarëve.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. U fol për punësime në QKMF: E para e punës duhet të nisemi prej kronologjisë sesi janë bërë punësimet në komunën tonë! Nuk është Smajl Latifi kryetar që 23 vite, është mandati i tretë (7 vite qeverisje) dhe si pyetje e kam, si janë punësuar tjerët e partive tjera prej pas luftës e deri sot?! Mendoj që është paragjykim kur thuhet që ka direkt ndikim në punësime. Meqenëse jam jurist dhe nëse pretendoni që ka pasur shkelje në konkurse, ju kallxoj formën: Fillimisht duhet ta bëni një ankesë në inspektoriatin e punës, pastaj një kallëzim penal në stacion të policisë dhe kur të vërtetohet kanë të drejtë ta bëjnë një padi në kontest civil. Më ka bërë përshtypje kryetari i ish partisë time, Albin Kurti, në një emision thotë që ai ka votë më shumë sesa tri partitë opozitare bashkë. Duke e bërë një analogji që në komunën tonë Smajl Latifi në raundin e parë i ka marrë individualisht 10.144 vota (47.18%), VV 5341, LDK 3424. Në raundin e dytë: Smajl Latifi i ka 11.575 vota (65.19%). Sa i përket punime në komunë, ka faktor të ndryshëm, faktori kryesor është moti, është mirë që kanë filluar dhe do të përfundojnë të gjitha. Nëse Burimi pretendon që në QKMF është tenderi i kurditur, e këshilloj ta bëjë një kallëzim penal.

Fahrije Lushi – Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, kryetar dhe të gjithë të pranishmit. E kam një shqetësim të banorëve të fshatit Ratkoc, kemi një “shëtitje” të madhe të qeneve endacak në qendër të fshatit. Kjo dukuri kërkon konsideratë.

Burim Krasniqi – Nuk ka qenë partia kaq e madhe, por e kanë bërë këta! Koha.net dhe Insajderi thonë që tenderi me pajisje mjekësore në QKMF, e ka bërë vetë paramasën dhe e ka fituar tenderin, por OSHP-ja e ka anuluar. Nuk gjykova, vetëm pyeta se cilat masa janë marrë!

Arber Zenuni – Përshëndetje kryesues, kryetar, kolegë. Nuk besoj që ka pasur ndonjëherë opozitë më zhurmuese, arsyeja dihet, po bëhet punë. Sa i përket projekteve, në mandatin e kaluar është bërë një projekt i madh në qendër të qytetit, që ka sjellur rekreacion të madh, pra është ndërtimi i palestrës. Në këtë mandat, ju bëj kërkesë që t’i drejtoheni shefit të juaj, Kryeministrit Albin Kurtit, ta vizitojë Rahovecin dhe t’i tregoni që Smajl Latifi ka nisur disa projekte dhe i duhet ndihma financiare.

Sejfullah Sejfullahu – Drilon, ne jemi opozitë që bëjmë pak zhurmë sepse kemi presion prej njerëzve, atyre që na kanë votuar dhe banorëve. Mendoj që nuk është korrekte të heshtim! Duhet të bisedojmë për çështjet që mund të arrihen dhe çdo herë për gjëra të mira “i rrehim shuplakat”. Por, nuk e dimë se çka t’iu themi banorëve, Krusha e Madhe 7000 banorë nuk ka fushë sportive.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarin e komunës, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së, media. I kam dy çështje: Njëra është për drejtorinë e Shërbimeve Publike rreth rrugëve fushore, në Celinë a është në plan të bëhet ndonjë metër rrugë fushore? Nëse po, është një rrugë shumë e rëndësishme që e lidh Celinën me Fortesë (nëpër vreshta) dhe do të ishte mirë (nëse ka mundësi buxhetore) të shtrohet të paktën me shavorr, duke iu mundësura bujqëve t’i kryejnë punët e tyre. E dyta ka të bëjë me punën e kuvendit të komunës. Në fillim të kësaj legjislature, i kemi zgjedhë komitetet obligative dhe disa komisione! Sa e shoh unë, komisionit nuk janë duke raportuar në kuvend, përkundër asaj që për këtë punë i kemi zgjedhur. P.sh. Komisioni për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe të lagjeve në qytet: Është keq që nuk e kemi raportin këtu, të jemi në dijeni si janë kryer zgjedhjet, a janë kryer në të gjitha fshatrat, a ka pasë pjesëmarrës dhe a kanë qenë zgjedhje të bazuara në rregulloren e kuvendit! Në fund, anëtarët e kuvendit duhet t’i mbrojnë interesat e qytetarëve pavarësisht a janë pozitë apo opozitë dhe nuk është mirë të bëjmë polemika mes vete. Në këtë drejtim është mirë të reflektojmë edhe kryesuesi

sepse ekzekutivi është ai që është përgjegjës për të gjitha zhvillimet dhe punimet që kryhen në territorin e Komunës së Rahovecit.

Merisa Sharku – Është mirë që kryetari t'i thotë grupit të vet që nuk kanë nevojë ata të japin përgjigje përderisa kryetari është i pranishëm në seance. Përderisa ata e shfrytëzojnë këtë të drejtë, p'e shfrytëzoj edhe unë. Replikë - Hasanit: Puna e papërfunduar është e barabartë me zero. Projektet po fillohen se ndoshta është mënyra më e lehtë për keqpërdorim (pa paragjykim, është mendim personal). Replikë - Sinanit, "mos e vet se t'kallxon vet"!

Lirigzon Kastrati – Dua të replikoj sepse kolegu Sinan e artikuloj tenderit në QKMF. Njoftimi për anulim të tenderit të datës 11.05.2023, e ka nxjerrë organi i prokurimit. Ai e ka dhënë një bazë juridike për anulimin e këtij tenderi. Ku dyshohet që operatori ekonomik ka ndikuar në përpilimin e listës së çmimeve. Neni 65 të Ligjit të Prokurimit, vetëm që e forcon atë që e tha Burimi.

Kryetari – I nderuar kryesues, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të LMT-së, drejtorë, media. Ju dëgjova me vëmendje dhe pajtohem që në fokus duhet të jetë interesi publik. U diskutua edhe numri i votave, por mos e harroni faktin që unë e respektoj edhe atë që nuk ka asnjë votë. Rrjedhimisht kushdo që ka qejf të ndërtojë karrier politike, le të vazhdon të bëjë fushatë, por mos harroni që edhe 2 vjet e gjysmë nuk ka zgjedhje. U diskutur çështja e një tenderi, faleminderit Lirigzon, kësaj radhe ti ke qenë më i saktë sesa shefi yt. Ky tha: E ka anuluar OSHP-ja, ti the autoriteti kontraktues (zyra jonë e prokurimit), pra, e vërteta është ashtu siç the ti. Është një OJQ që e ka konsideru si të një të gjetur, e ka lajmruar Komunën e Rahovecit dhe zyra e prokurimit ka vepruar mirë që e ka ndërprerë procedurën (tender i anuluar). Çështja shtrohet, pse nuk kemi vepruar më herët! Po, unë nuk e kam përvojën e dikujt që ka punuar në Ministrinë e Infrastrukturës për detaje të tenderave, unë nuk jam shef i tenderave. Nuk e lejoj askënd të më cilësojë si "tregtar"! Ndoshta dikush ka përvojë nëpër këto gjëra dhe nuk është mirë të na shesë "pollavra" askush hiç. Në çoftëse bëhen gabime ose defekte në paramasa, dhe në hartimin e projekteve, ju lutem të drejtoheni te ata që janë kompetent përmes ndonjë ankese apo ndonjë kallëzimi penal. Nëse zyra e prokurimit nuk do ta anulonte, natyrisht që unë kam të drejtë të marr masa të caktuara ndaj shefit të prokurimit. Kjo temë është mbyllur me asnjë pasojë financiare. Sa i përket punësimeve: Të gjitha janë me procedurë të rregullt, duke u zhvilluar procedurat në përputhje me ligjin. Njerëzit dëshirojnë të punojnë dhe është shumë mirë që po punësohen. Problemin e kam me konkurrencën, numrin e kufizuar të atyre që kërkohen – Ky është problem që e ka prodhuar paslufta jonë. Punësohen njerëzit dhe do të punësohen çdo here, duke u munduar sado pak ta ndalojmë ikjen e dhimbshme që po ndodh. Sa i përket punishteve, kemi disa punishte të hapura. E di që nuk mund të "ndreqet" diçka pa u "prishë"! Dikush e përmendi këtu që "puna e papërfunduar është e barabartë me zero". Me teknologjinë dhe revolucionin që po ndodh nëpër botë, ndoshta ka mundsi të kryhen punët pa u nisë hiç!!! Por, unë nuk kam unë informacione të tilla, që pa ia nisur punës, të kryhet puna! Ne i kemi nisur disa punë sepse besoj në realizim, vetëdije, koncept dhe vizion. Rruga "Ali sokoli" do të asfaltohet së shpejti, fillimisht janë duke u bërë disa veprime që lidhen me puseta dhe kablllo. Rrugën në qendër kemi menduar ta përfundojmë në fund të muajit maj, por nuk besoj që vonohet edhe shumë ajo pjesë, do të rregullohet para kohës së ardhjes së mërgimtarëve. Gjithashtu për sheshin në qendër, vazhdon puna në të. Në Sheshin Republika do ta bëjmë edhe një rrugë me gurë, përmes këtij projekti të kontribohet në ruajtjen e trashëgimisë. Koha për sheshin qëndror është tani, përkundër disa vështirësive që lidhen me pëlqime energjetike të KEDS-it, me KRU-Gjakovën dhe të cilat i kanë procedurat e veta. Sheshi qëndror do të bëhet me bindje të plotë, duke u bërë opozitë për operatorin për përshpejtimin e punës, në 2025 llogaritet të përfundojë. Punësimeve mund t'i japim dimensione të ndryshme. Jemi një familje e madhe me rreth 60.000 banorë, gati shumica njihemi me njëri tjetrin apo kemi lidhje të ndryshme familjare. Për dallim nga kryetarët tjerë, unë asnjëherë nuk i kam prekur të punësuarit që i kam gjetur në punë, pasi që e kam fituar mandatin. U tha këtu që po punoni vetëm punë të vogla! Pasnesër me 1 qershor, po i përurojmë dy qerdhe dhe mos i minimizoni punët e mira sepse janë vepra të mëdha që iu dedikohen fëmijëve. Sa i përket fushës sportive në Krushë të Madhe, do ta bëjmë një të tillë sepse e meriton, gjithashtu edhe një sallë të edukatës fizike. Sa i përket përmbaruesit, duke i parë edhe raportet e komunave tjera, komuna jonë nuk është keq në këtë aspekt. Nuk mund t'i shmangemi përmbaruesit sepse brenda 30 dite lënda dërgohet në gjykatë, përfundojnë procedurat dhe vjen te përmbaruesi, ato janë pasqyra dhe ne e kemi për obligim t'i jemi transparentë. Rasimi i përmendi rrugët fushore: Kemi filluar me rrugë fushore në Rahovec sepse është pjesë më e terun. Do të vazhdojmë të operojmë tutje pozitivisht edhe në Celinë dhe në shumë pjesë tjera. Për qentë endacak kemi një kontratë dhe kanë filluar të trajtohen, do të ketë më pak qenë endacak ditëve në vijim nëpër vendbanime sepse jemi duke i trajtuar. Qytetin synojmë ta bëjmë me standarde të larta, të mos kemi më kablllo elektrike mbi tokë, t'i fusim nëntokë dhe t'i rregullojmë pusetat që janë aty. Jam prej atyre që mendoj

pozitivisht dhe punët që nisen do t'i përfundojmë. Projekti i Zonës Ekonomike është certifikuar nga ministria, do ta shohim mundësinë nëse është e nevojshme të bëjmë ndonjë hyrje tjetër gjatë punimeve. AMF-ja në Xërxë shpresoj dhe besoj që do të bëhet QMF edhe pse duhet të kemi më shumë buxhet sepse kostoja dyfishohet. Për mirëmbajtjen e AMF-ve, punëtorët e pastrimit shkojnë një herë në javë për pastrim sepse AMF-të kanë shumë pak pacientë. Personeli mund t'i pastrojë vet zyret ku rrinë! Le të punojnë më shumë sepse buxheti i komunës ka kapacitet të vogël në këtë drejtim.

Burim Krasniqi – Në ministrinë e Infrastrukturës nuk e di që ka punuar ndonjë asambleistë tjetër këtu përpos meje dhe vazhdimisht nuk ka dashur të hyjë në këto lojëra. Karrierën time profesionale e kam filluar në vitin 2003 në komunë të Rahovecit si inspektor, kam vazhduar në ministri si 23 vjeçar. Për dallim prej deklarimeve tua kryetar, kur keni thënë vazhdimisht për diçka që nuk e keni ditur, “kur kam ardhë si kryetar komune e kam mësuar”! Unë jam ekspert i licencuar i komunikacionit dhe makinerisë prej 2003. Kam punuar në mbi 4000 ekspertiza deri sot, në qoftëse e merr një pagesë mesatare prej 80€, dalin mbi 300.000€ dhe ka qindra realizime tjera me qindra mijëra euro. Është fakt që unë nuk jetoj me qera, por është një fakt i dytë që përkundër krejt kësaj pune, nuk kam para të kursyera në llogari dhe i kam 100.000€ kredi si biznes dhe si familje. Siç e thoni ju, “unë jam Smajl Latifi” edhe unë jam Burim Krasniqi dhe nuk frikësohna para kërkujt, asnjë milimetër të karrierës dhe angazhimit tim profesional dhe politik. Mirë e dhe përgjigjen në fund për anulimin e tenderit, por jo edhe në fillim kur tentove nëse rasisht “po tutet” dhe po ma ndal gojën. Kryetar, këtë praktikë të lutem harroje dhe bëhu konstruktiv. Kurrë në karrierën time nuk kam punuar në zyrë të prokurimit, asnjëherë në vlerësim të ofertave dhe asnjëherë në pranime teknike.

Kryetari – Askush nuk e akuzojë askënd dhe askush nuk e detyron askënd ta deklarojë qfarë pasurie, ka sepse është agjencioni anti – korrupsion për këtë gjë. Dikush e përmendi që 4000 kontrata i ka nënshkruar, mund të jenë edhe 100 dhe në ato të ketë gabime! Me 4000 kontrata duhet të jetë administrata e Tokios dhe mund të ketë gabime. Me 4000 ekspertiza të nënshkruara, del të jetë një super ekspert që nevojë të konkurron në zyrë të prokurimit për të bërë super ekspertiza. Ai që ia nisë i pari do të jem këtu, nëse ia nisë Burimi, jam 24 orë këtu. Nuk foli para kohë asnjëherë, por nëse dikush dëshiron ta sfidoj jam këtu dhe nuk lejoj askënd të luaj me dinjitetin dhe nderin tim. Nëse nuk ka punuar ky në zyrë të prokurimit asnjëherë, ka punuar te patent shoferat! Ruaje pak veten dhe mos u shtyj me kryetari sepse të shtyhesh me mua është njëjtë si të provojmë që me gishtin e vogël të këmbës së majtë, ta prekim veshin e djathtë. E treta herë që në këtë foltore prodhohet ironi, fyerje dhe cinizëm në adresë të kryetarit, nga ti. Prit edhe 2 vjet e gjysmë, le të përfundojë mandati, fitoi zgjedhjet dhe tani bën punë të mëdha me super ekspertiza si super ekspert me mbi 4000 ekspertiza.

Ilir Pallqa – Faleminderit i dashur kryesues! Siç ju thash, kryetari po udhëheq me fjalime të rrjedhshme dhe manipulime, pa punë. Tani që po mendoj edhe po punon, sepse disa prej punëve që priten të kryhen këto ditë janë: Punësimi i vajzës së vllaut të kryetarit, punësimi i vajzës së motrës së nënkryetarit, nusja e gruas së nënkryetarit, gruaja e drejtorit të ekonomisë, gruaja e shefit të asambleistëve të AAK-së, kandidatja për asamble nga AAK, gruaja e asambleistit të AAK-së, aktivisti i AAK-së dhe vajza e shokut të kryetarit.

Feriz Thaqi – Ilirit duhet t'i tregoj që 78% i ka kryetari dhe mund t'i dalin të njofshëm ata që punësohen!

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Ky nxitet dhe dhezet vetvetiu. U përmend bashkëshortja e shefit të asambleistëve të AAK-së. Kryetari tha çka keni kundër konkurseve, e keni gjykatën afër. Disa po frigohen të shkojnë atje sepse i ka ra shpesh dhe nuk iu ka dalë mire. Bashkëshortja ime që 4 vite që është e diplomuar dhe i ka dy licenca. Derisa unë kam qenë drejtor në 4 vite në asnjë konkurs nuk ka aplikuar. Në qoftëse ajo e ka fatin e keq që e ka burrin politikan, kjo nuk do të thotë që mos të aplikojë në asnjë konkurs. Pse nuk e përmende që ka dështuar në konkursin për infermieri. Sa i përket punësimeve familjare, ju jeni të fundit që e keni shkelë këtë parim, e më pas dilni nëpër televizione duke thënë që i kemi 51% nuk mund t'i shmangemi. Atëherë ne që jemi me mbi 65% i bie që çdo 1.5 qytetarë të punësohet.

Kryesuesi – Atëherë shkojmë me pauzë rreth një orë...

Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, zyrtarë, anëtarë të kuvendit komunal. Para se të rifillojmë dua të jap një vërejtje për ata që kanë diskutuar pas diskutimeve të seancës dhe ju lutem që gjatë diskutimeve brenda sallës së kuvendit të jemi më të qetë, sepse jemi të zgjedhur me votë dhe duhet të kemi etikë të punës. Nëse e kemi mirëkuptimin mund ta përmbylim pikën e dytë të diskutimeve.

1. Informatë mbi Qarkoren e Parë buxhetore 2024/1;

Afrim Limani – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, asambleistët. Me datë 15.05.2023 në adresë të Komunës së Rahovecit ka ardhur qarkorja e parë buxhetore për vitin 2024-2026. Në këtë qarkore janë të caktuara limitet dhe tavanet buxhetore për buxhetin e vitin 2024 dhe projeksionet 2025-2026. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024 në total është 21.340.785€. Nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku buxheti ka qenë prej 17.548.000€, atëherë kemi ndryshim pozitiv prej 2.486.000€. Buxheti është i shpërndarë në grante kështu: Në grantin e përgjithshëm kemi 8.486.000€, granti për këshillin e Hoçës së Madhe 29.071€, shërbimi rezidencial është 230.000€ (këto shërbime janë duke u buxhetuar për here të pare), ty hyrat vetanake 1.614.904€, në grantin specifik të arsimit janë 7.138.000€, granti i shëndetësisë është 2.536.000€. Përafërsisht është kështu, e presim edhe qarkoren e dytë buxhetore dhe aty përcaktohen definitivisht limitet apo tavanet. Në pozicion të pagave kemi 10.300.000€, mallra dhe shërbime 2.466.000€, komunalit 370.000€, subvencione 890.000€ dhe investime kapitale mbi 6 milion.

Burim Krasniqi – Drejtor, te rritja e buxhetit në bazë të qarkores buxhetore a ka të bëjë kryesisht për shkak të ligjit për paga dhe sa është rritja te investime kapitale?

Afrim Limani – Buxheti në total duhe përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike, ka një rritje prej 2.486.000€ dhe rritje është kryesisht është në pozicionin e pagave. Te investime kapitale kemi një diferencë të rritjes prej 356.139€.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për marrjen e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë për 15 vjet. Bëhet fjalë për parcelën me numër 01910-6, në zonën kadastrale – Retijë. Kërkojmë të marrim vendim për 3 ha, me qëllim të destinimit bujqësor.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510069-01910-6, në zonën kadastrale – Retijë;

Në të njëjtën kohë, kërkojmë prej juve formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për të njëjtën parcelë 01910-6. Komisioni si zakonisht përbëhet prej 5 anëtarëve: Dy prej ekzekutivit, dy prej kuvendit dhe një nga sektori joqeveritar. Ftoj anëtarët e kuvendit që t'i votojnë vendimet veç e veç.

Burim Krasniqi – Drejtor, në propozim thuhet 3000 m², a është gabim teknik, a është 30 ari apo 3 ha?

Afrim Oruqi – Faleminderit kuvendarit Burim Krasniqi, ka qenë një gabim teknik që na ka rrjedhë në numra, e kemi korrigjuar në vendim të ri. Bëhet fjalë për 3 ha ose 30.000m².

Kryesuesi – Atëherë po e vendosim në votim pikën e katërt të rendit të ditës, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet kjo pikë. Vazhdojmë me propozimin e vendimit për formim të komisionit. Dy anëtarë të ekzekutivit janë të emëruar, Besmire Bytyqi dhe Berat Duraku. Neve na mbetet që t'i zgjedhim dy anëtarë tjerë nga kuvendi dhe sa për informim do të formohet edhe një komision tjetër pos këtij, në çoftëse grupet e asambleistave kanë mirëkuptim për vendosjen e anëtarëve, nëse jo, do të zgjedhim me vota.

Hasan Përboqi – Në emër të grupit të AAK-së propozojmë, Shukrije Himaj.

Leonard Morina – Faleminderit kryesues, LVV nuk ka propozim!

Burim Krasniqi – LDK nuk ka propozim!

Bejtullah Deliu – PDK nuk ka propozim!

Kryesuesi – Shumë mirëkuptim i thellë ky! Atëherë i ftojme edhe një herë tre grupet që nuk patën propozime, ta shqyrtojnë mundësinë e një propozimi.

Lirigzon Kastrati – Atëherë ne e propozojmë Eqrem Spahiu-n.

Kryesuesi – Faleminderit Lirigon. Atëherë dy antarët e deleguar nga kuvendi janë: Shukrije Himaj dhe Eqrem Spahiu. Me këtë përbërje po e vendosim në votim pikën e pestë, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e pestë.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;

Afrim Oruqi - Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Ballacërk, për dhënien në shfrytëzim 15 vjet me nr. të parcelës 01002-0 dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej 38 ari e 58m². Qëllimi ka të bëjë me rritjen e vlerës dhe kultivimin e bujqësisë dhe blektorisë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 71510002-01002-0, në zonën kadastrale – Bellacërkë;

Afrim Oruqi – Kërkohe formimin i komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, bëhet fjalë për parcelë dhe sipërfaqe të njëjtë me komision prej 5 anëtarëve. Ftoj anëtarët e kuvendit që t'i votojnë vendimet veç e veç.

Kryesuesi – Atëherë, a ka dikush diçka për të thënë rreth pikës së gjashtë?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Tani jemi te pika e shtatë, nëse dikush prej anëtarëve të kuvendit ka diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë vazhdojmë me procedurën e njëjtë, i kemi dy anëtarë që duhet t'i delegojmë nga kuvendi, nga ekzekutivi janë të emëruar anëtarë të njëjtë: Besmire Bytyqi dhe Berat Duraku. I ftoj më grupet e asambleistëve për propozime.

Hasan Përboqi – AAK, Afrim Berisha.

Merisa Sharku – LVV, nuk ka propozim.

Burim Krasniqi - LDK, nuk ka propozim.

Bejtullah Deliu – PDK, Sejfullah Sejfullahu.

Kryesuesi – Atëherë, dy të deleguarit nga kuvendi janë Afrim Berisha dhe Sejfullah Sejfullahu dhe me këtë përbërje po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-7151057-02240-1, në zonën kadastrale – Rahovec;

Afrim Oruqi - Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec në sipërfaqe prej 10.000m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 757 ha 40 ari e 1m². Prej kësaj sipërfaqe, kërkojmë nga ju që të shpallim me interes të përgjithshëm vetëm 1 ha. Bëhet fjalë për parcelën që së fundmi prof.dr. Sabahajdin Cena e ka kaluar kohën e lirë aty. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik është këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë koment rreth këtij propozimi? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash, miratohet edhe pika e tetë.

Para se të vazhdojmë me pikën e 9-të, projekti DEMOS në bashkëpunim me MAPL ka planifikuar që të mbajë një trajnim njëditor (7 qershor, duke filluar nga 09:00) për të gjithë anëtarët e kuvendit komunal të Rahovecit rreth sistemit të menaxhimit të performancës komunale, grantit të performancës dhe platformës elektronike

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme P-71510052-00363-0, zona kadastrale - Mrasor;

Afrim Oruqi - Faleminderit kryesues! Propozohet të jepet pëlqimi për të iniciuar procedurën për shpronësim të pronës së paluajtshme private për interes të përgjithshëm publik për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e shtëpisë – shtapit të UÇK-së në zonën e Mrasorit. Çertifikata e pronësisë është në emër të Sokol (Rexhë) Rexhepi me sipërfaqe prej 240m², kjo sipërfaqe në total është 1ha 6 ari e 10m². Kërkojmë prej juve pëlqim për shpronësimin e kësaj sipërfaqe në sipërfaqe prej 2 ari e 40 m² të bashkëngjitur e keni edhe skicën me koordinata të terrenit.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Drejtor, vlera e shpronësimit, caktohet tani apo?...

Afrim Oruqi – Sipas ligjeve, neve na takon vetëm marrja e vendimit. Elaborati dërgohet në ministri të financave në një sektor të veçantë, aty është një departament që merret me vlerësim.

Kryesuesi – Faleminderit! Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 9-të.

10. Shfuqizimi i vendimit Nr.62/2023 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në 2023;

Kryesuesi – Gjatë propozimit për pikë shtesë, e thash arsyeshmërinë e shfuqizimit të këtij vendimi. Ne si kuvend obligohemi ta shfuqizojmë brenda 30 ditëve, meqenëse ministria e Financave e ka marrë një vendim tjetër i cili nuk përputhet me këtë këtu. Nëse dikush prej anëtarëve nuk ka ndonjë gjë për diskutim, po e vendosim në votim! Kush është për? ... Me shumicë votash shfuqizohet vendimi Nr. 62/23 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në 2023.

Kryetari – Faleminderit kryesues! Do ta vendosim edhe një herë seancën e ardhshme në rend dite, vendimin për bartjen e mjeteve sepse nga kodi 22 na rikthehen mjetet dhe kjo tani është argument që vonesat janë evidente, por pa fajin tonë.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar! Atëherë, këtu po e përmbylлим seancën e sotme, shihemi në seanca tjera.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu



SHKUTËRJA E KRYETARËS BASHKËSI KOMUNALE PËR KËSHILLARË
DHE KËSHILLARË TË LAGJEVE URBANE, FSHATRAVE DHE VENDBANIMEVE NË
KOMUNËN E RAHOVECIT



RAHOVEC / ORAHOVAC

Nr./Br./No. (Kryesia e Komunitetit)

Nr./Br./No. 85 Nr./Br./No. 4/23

Data/Date/Date 06.06.2023

**RAPORT - PROCESVERBAL MBI
ZGJEDHJEN E KRYETARËVE DHE
KËSHILLAVE TË LAGJEVE URBANE,
FSHATRAVE DHE VENDBANIMEVE NË
KOMUNËN E RAHOVECIT**

RAPORT - PROCESVERBAL

**Komisioni për zgjedhjen e Kryetarëve
dhe Këshillave të lagjeve urbane,
fshatrave dhe vendbanimeve në
Komunën e Rahovecit**

HYRJE.....3

ECURIA E PROCESIT SË ZGJEDHJES SË KRYETARËVE DHE KËSHILLAVE TË LAGJEVE URBANE, FSHATRAVE DHE VENDBANIMEVE NË KOMUNËN E RAHOVEÇIT.....5

FSHATI BRESTOC.....5

FSHATI HOÇE E VOGEL.....6

FSHATI NAGAC.....7

FSHATI CELINE.....7

FSHATI KRUSHË E MADHE.....8

FSHATI MALESI E VOGEL.....9

FSHATI GEXHË.....10

FSHATI RATKOC.....11

FSHATI DEJNE.....12

FSHATI VRAJAKE.....12

FSHATI BRATOTIN.....13

FSHATI DOBIDOL.....14

FSHATI ÇIFLLAK.....14

FSHATI POLLUZHË.....15

FSHATI KRAMOVIK.....16

FSHATI GURI I KUQ.....17

FSHATI MRASOR.....18

FSHATI FORTESE.....19

FSHATI SAPNIQ.....19

FSHATI XËRXE.....21

FSHATI PATAQAN I ULËT.....21

FSHATI PATAQAN I EPËRM.....22

FSHATI NUSHPAL.....23

FSHATI DRENOC.....24

FSHATI ZATRIQ.....24

FSHATI PASTASEL.....26

FSHATI KAZNIK.....26

FSHATI OPTERUSHË.....27

FSHATI ZAQISHT.....28

FSHATI HOÇE E MADHE.....28

RAHOVEÇ - LAGJIA I.....1

RAHOVEC – LAGJJA II	29
RAHOVEC – LAGJJA III	30
RAHOVEC – LAGJJA IV	31
RAHOVEC – LAGJJA V	31
ISHATI RETJË	32
ISHATI RETJË E ULËT	32
PËRFUNDIM	36

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit/Opština Oraovaca/Municipality Rahovec

Data/Date:	31.03.2023
Për/Za/To:	Kryetarin e Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi Kryesuesin e Kuvendit Komunal në Rahovec, z. Dëtrim Kafexhiu Kuvendin Komunal Rahovec
Nga/Od/From	Komisioni për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit
Tema/Subjekat/Subject	Raport – Procesverbal mbi zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit

Të nderuar,

Në vazhdim po ju raportojmë për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit

Në bazë të nenit 11, nenit 12 pika 12, paragrafi 12.2 pika(c), nenit 34 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.3, nenit 13, nenit 40, paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi Komunal i Rahovecit më datë 29.03.2021 ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në tërë territorin e Komunës së Rahovecit.

Me anë të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Rahovecit është rregulluar mënyra e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar kështu Këshillat lokal si trupa mbështetës të organeve të Komunës dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Në mbështetje të nenit 12, shkronja(d), neneve 17,34 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës-Nr.28/15 qershor2008), nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane,në territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178.21 të datës: 29.03.2021, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2022 ka marrë këtë VENDIM:

Vendim për emërimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Rahovecit.

Komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka udhëhequr dhe koordinuar punën në terren për zgjedhjen e këshillave lokal.

Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokal përbëhet nga gjithsej 7 anëtarë: 4 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 1 anëtar nga Ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe 1 përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane.

Kryesuesja e Komisionit është zgjedhur nga anëtarët e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal në Komunën e Rahovecit janë:

1. Melinda Oruçi – Iska – anëtare e Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të PDK-së;
2. Faton Ramadani - anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit - të LDK-së;
3. Afrim Berisha – anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të AAK-së;
4. Leonard Morina - anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të LVV – së;
5. Nora Boshnjaku- anëtare nga Ekzekutivi i Komunës;
6. Vjollca Gurgule - anëtare nga Shoqëria Civile, SHL- Kosova;
7. Përfaqësues të fshatrave, vendbanimeve ose lagjeve urbane.

Komisioni ka mbajtur procesverbal për çdo tubim konform Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178.21 të datës: 29.03.2021. Poashtu janë evidentuar edhe listat e pjesëmarrësve si dhe fotografi nga takimet e zhvilluara.

Ky Komision i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka bërë caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokal dhe kryetarëve të këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Nëpërmjet Zyrës për Informim Komisioni i emëruar nga Kuvendi Komunal Rahovec ka informuar qytetarët 15 ditë para mbajtjes së tubimit për zgjedhjen e këshillave lokal përmes mediave lokale, ueb-faqes zyrtare të Komunës me përmbajtje të datës, kohës dhe vendit të mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokal: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/Njoftim-Publik-per-zgjedhjen-e-kryetareve-keshillave-te-lagjeve-urbane-fshatrave-dhe-vendbanimeve-ne-komunen-e-Rahovecit.pdf>.

Takimet me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokal kanë filluar nga data: 20.06.2022 dhe kanë përfunduar më datë: janë mbajtur gjithsej 29 takime me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokal në gjithsej 26 fshatra të Komunës së Rahovecit, dhe në tri lagje urbane të qytetit të Rahovecit.

Gjatë procesit zgjedhor është vërejtur një interesim relativisht i kënaqshëm i banorëve të lokaliteteve të ndryshme sa i përket zgjedhjes së këshillave lokal dhe kryetarëve të këshillave.

Përfaqësimi gjinor në këshilla patjetër që është i domosdoshëm, procesi gjatë gjithë kohës ka ecur mirë nuk ka pasur ndonjë parregullsi, gjithçka ka vajtur në mënyrë të rregullt dhe konform rregullores.

Në vijim po paraqesim procesin e zgjedhjes së Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit, deri më datën:

ECURIA E PROCESIT SE ZGJEDHJES SE KRYETAREVE DHE KESHILLAVE TE LAGJEVE URBANE, FSHATRAVE DHE VENDBANIMEVE NE KOMUNEN E RAHOVECIT

FSHATI BRESTOC

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës	F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Bresotc	Objekti shkollor 20.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-KESHILLAVE-TE-LAGJEVE-URBANE-FSHATRAVE-DHE-VENDBANIMEVE-NE-KOMUNEN-E-RAHOVECIT-2.pdf	0	2	2	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Brestoc, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të keshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të fshatit Brestoc është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të keshillit të fshatit Brestoc.

FSHATI HOÇE E VOGËL

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës	F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Hoçe e Vogël	Objekti shkollor 20.06.2022 19:30	https://kk.rks-rov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-KESHILLAVE-TE-LAGJEVE-URBANE-FSHATRAVE-DHE-VENDBANIMEVE-NE-KOMUNEN-E-RAHOVECIT-2.pdf	0	3	3	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit Hoçe e Vogël, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të keshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të fshatit Hoçe e Vogël është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të keshillit të fshatit Hoçe e Vogël.

FSHATI NAGAC

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Nagac	Objekti shkollor 21.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-DHE-LAGJEVE-URBANE-NAGAC-DHE-CELINE.pdf	2	14	16

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Nagac, është zhvilluar ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, ndërsa me propozimin dhe aprovimin e qytetarëve të pranishëm anëtar i komisionit nga fshati Nagac u emërua z. Fatmir Gashi.

Arian Gashi – Kryetar i këshillit të fshatit Nagac, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim si dhe njëlkohësisht i ftoi të pranishmit të zgjidhnin kryesinë e re të fshatit Nagac!

Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Nagac ishin si në vijim:

Fatmir Gashi – propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Nagac: z. Arian Gashi.

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Nagac nuk kishin propozime të tjera, u votua në mënyrë unanime për z. Arian Gashin si Kryetar i ri i fshatit Nagac.

Banorët e fshatit Nagac, me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë gjithmonë duke respektuar edhe përfshirjen e gjinisë femërore në këshill.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Nagac ishin si në vijim:

1. Arian Gashi
2. Hysni Gashi
3. Fatmir Gashi
4. Dafina Gashi
5. Nebih Elshani
6. Xhemajli Krasniqi
7. Valmir Gashi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Nagac në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit Nagac, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18:00.

FSHATI CELINE

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Celine	Objekti shkollor 21.06.2022 19:30	<a href="https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-
PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-KESHILLAVE-
TE-FSHATRAVE-DHE-LAGJEVE-URBANE-
NAGAC-DHE-CELINE.pdf">https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep- content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM- PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-KESHILLAVE- TE-FSHATRAVE-DHE-LAGJEVE-URBANE- NAGAC-DHE-CELINE.pdf	1 35 36

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Celine, është zhvilluar, ashtu siç ishte e parapare në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Muhamet Ramadani – Kryetar i keshillit të fshatit Celine, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim si dhe kontributin e tyre për fshatin, njëkohësisht i ftoi të pranishmit të zgjidhnin kryesinë e re. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajten e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Celine ishin si në vijim:

Shemsedin Rexhepi – propozoi për kryetar të keshillit të fshatit Celine – Muhamet Ramadani.
Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Celine, nuk kishin propozime të tjera, u votua në mënyrë unanime për z. Muhamet Ramadani si Kryetar i ri i fshatit Celine.
Banorët e fshatit Celine, me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë.

Të propozuarit për keshillin e fshatit Celine ishin si në vijim:

1. Muhamet Ramadani
2. Manush Fazliu
3. Shyqeri Jemini
4. Zenun Rexhepi
5. Fitim Sinani
6. Milazim Kadriu
7. Bujar Dina

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e keshillit të fshatit Celine në përberje prej 7 anëtarësh.
Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të keshillit të fshatit Celine, duke u dëshiruar punë të mbare dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19:30.

FSHATI KRUSHE E MADHE

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit	Objekti i Shtëpisë së Kulturës 22.06.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-KRUSHE-E-MADHE.pdf	1	24	25

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Krushë e Madhe, është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Selami Hoti – Kryetar i këshillit të fshatit Krushë e Madhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim si dhe kontributin e tyre për fshatin, njëkohësisht i ftoi të pranishmit të zgjidhnin kryesinë e re. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit. Edhe përkundër pjesëmarrjes, qytetarët e Krushës së Madhe nuk kanë arritur të zgjedhin Këshillin e fshatit e as Kryetarin e Këshillit të fshatit Krushë e Madhe.

Takimi përfundoi në ora 20:00.

FSHATI MALËSI E VOGËL

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Malësi e Vogël	Objekti shkollor 23.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-Radoste-dhe-Gexh.pdf	1	33	34

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit, Malësi e Vogël është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Enver Çadraku – Kryetar i këshillit të fshatit Malësi e Vogël, hapi takimin meqë rast falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim si dhe kontributin e tyre për fshatin, njëkohësisht i ftoi të pranishmit të zgjidhnin kryesinë e re.

Leonard Morina anëtar i Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Malësi e Vogël ishin si në vijim:

Elami Krasniqi propozoi : Murat Morina

Liridon Lushi propozoi: Enver Çadraku.

Enver Çadraku, është deklaruar se nuk dëshiron që të jetë pjesë e zgjedhjeve për Kryetar të këshillit të fshatit Malësi e Vogël, propozime të tjera nuk ishte, andaj i vetmi i propozuar për Kryetar të këshillit të fshatit ishte Murat Morina, propozim ky që u hodh në votim.

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Celinë, nuk kishin propozime të tjera, u votua në mënyrë unanime për

z.Murat Morina si Kryetar i ri i këshillit të fshatit Malësi e Vogël.

Banorët e fshatit Malësi e Vogël, me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 9 anetare.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Malësi e Vogël ishin si në vijim:

1. Murat Morina
2. Afrim Zena
3. Avdi Krasniqi
4. Taip Rustemi
5. Muhamet Luta
6. Endrit Ukaj
7. Lulzim Morina
8. Azem Lushi
9. Can Kastrioti

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e këshillit të fshatit Malësi e Vogël në përberje prej 9

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbare dhe suksese

në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19:10.

FSHATI GEXHË

Takimi	Vendi, data dhe ora embaftjes së takimit		
Takim me qytetarët e fshatit Gexhë	Objekti shkollor 23.06.2022 19:30	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-Radoste-dhe-Gexh.pdf	0 21 21
Pjesëmarrës	F M T		

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Gexhë, është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Gexhë ishin si në vijim:

Skender Krasniqi – propozoi për kryetar të keshillit të fshatit Gexhë: Nexhmedin Krasniqi.

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Gexhë, nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Nexhmedin Krasniqi si Kryetar i ri i fshatit Gexhë.

Banorët e fshatit Gexhë me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Gexhë ishin si në vijim:

1. Nexhmedin Krasniqi;
2. Millaim Morina;

3. Bajram Himaj;
4. Smajl Morina;
5. Skender Krasniqi;

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Gexhë në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 20:10.

FSHATI RATKOC

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Ratkoc	<u>Objekti i Shtëpisë së Kulturës</u> <u>24.06.2022</u> <u>19:00</u>	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/Zgjedhja-e-kryetareve-te-fshatrave-Ratkoc.pdf	16	128	144

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Ratkoc, u zhvillua ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit hapi takimin dhe informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Ratkoc ishin si në vijim:

- Ruzhdi Krasniqi propozoi – Beqë Shala
- Bekë Hoti propozoi – Jemin Hoti
- Mensur Hoti propozoi – Skender Hoti

Pasi që ishin më shumë se tre kandidatë të propozuar të tre kandidatët ju nënshtruan procesit të votimit të fshehtë.

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 147.

- Fletëvotime të vlefshme- 144
- Beqë Shala mori gjithsej : 129 vota
- Jemin Hoti mori gjithsej: 12 vota
- Skender Hoti mori gjithsej 3 vota.

Me 129 vota gjithsej Beqë Shala u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Ratkoc, i cili me një fjalë rasti falënderoi të gjithë për besimin duke cituar se së bashku me këshillin do punojnë në të mirë të fshatit.

Me propozimin e qytetarëve të fshatit Ratkoc dhe aprovimin e tyre këshilli i fshatit Ratkoc do të ketë gjithsej 5 anëtarë.

Të propozuarit për keshillin e fshatit Ratkoc ishin si në vijim:

- 1. Beqe Shala
- 2. Jemin Hoti
- 3. Minire Hoti
- 4. Bekim Krasniqi
- 5. Afrim Hoti

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Ratkoc në përbërje prej 5

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 20:35.

FSHATI DEJNË

Takimi	Vendi, data dhe ora embahtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Dejnë	Objekti shkollor 27.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-DEJN-VRAJAK-DHE-VRAJAK.pdf	0 58 58

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit Dejnë, u zhvillua ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të keshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit hapi takimin dhe informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Ratkoc ishin si në vijim:

- Ekrem Bytyqi propozoi – Beqe Shala
- Ramadan Krasniqi propozoi – Rexhep Krasniqi

Pasi që ishin më shumë se dy kandidatë të propozuar të dy kandidatët ju nënshtruan procesit të votimit të fshehtë.

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 58.

- Fletëvotime të vlefshme- 57
- Beqe Shala mori gjithsej : 43 vota
- Rexhep Krasniqi mori gjithsej: 15 vota

Me 43 vota gjithsej Muharrem Morina u zgjodh kryetar i keshillit të fshatit Dejnë, i cili me një fjalë rasti falënderoi të gjithë për besimin duke cituar se së bashku me keshillin do punojnë në të mirë të fshatit.

Me propozimin e qytetarëve të fshatit Ratkoc dhe aprovimin e tyre keshilli i fshatit Dejnë do të ketë gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Dejnë ishin si në vijim:

Muharrem Morina

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Dejnë në përbërje prej 7 anëtarësh. Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18:45.

FSHATI VRAJAKË

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
			F M T
Takim me qytetarët e fshatit Vrajkë	Objekti shkollor 27.06.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-DEJN-VRAJAK-DHE-VRAJAK.pdf	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Vrajkë, u zhvillua ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtarët e Komisionit hapën takimin dhe informuan të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Vrajkë ishin si në vijim:

Avni Morina– propozi për kryetar të këshillit të fshatit Vrajkë- Muharrem Morina

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Vrajkë, nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Muharrem Morinasë Kryetar i ri i fshatit Vrajkë.

Banorët e fshatit Vrajkë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Vrajkë ishin si në vijim:

Muharrem Morina

FSHATI BRATOTIN

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Bratotin	Objekti shkollor 27.06.2022 20:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-DEJN-VRAJAK-DHE-VRAJAK.pdf	0 0 0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit Bratotin, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të keshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të fshatit është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të keshillit të fshatit Bratotin.

FSHATI DOBIDOL

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Dobidol	Objekti shkollor 28.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-DOBIDOL.pdf	1 19 20

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit Dobidol, është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku kryesuese e komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Dobidol ishin si në vijim:

Ramiz Morina – propozoi për kryetar të keshillit të fshatit Dobidol: Kujtim Sopjani

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Dobidol, nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Kujtim Sopjani si kryetar i ri i fshatit Dobidol.

Banorët e fshatit Dobidol me akllamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë. Të propozuarit për keshillin e fshatit Dobidol ishin si në vijim:

1. Kujtim Sopjani
2. Lekë Gashi
3. Ukë Morina
4. Besim Morina
5. Kadri Rudi
6. Skënder Thaqi
7. Smajl Isakaj

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Dobidol në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 50.

FSHAT ÇIFLLAK

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Çifllak	Objekti shkollor 28.06.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-DOBIDOL.pdf	0	28	28

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Çifllak është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Çifllak ishin si në vijim:

Skender Krasniqi – propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Çifllak: Selajdin Gashi

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Çifllak nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Selajdin Gashi si Kryetar i ri i fshatit Çifllak.

Banorët e fshatit Çifllak me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Çifllak ishin si në vijim:

1. Selajdin Gashi
2. Skender Krasniqi
3. Rifat Thaqi
4. Faik Thaqi
5. Ajet Sahitaj
6. Durim Sahitaj

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Çifllak në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 50.

FSHATI POLLUZHË

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës	F M T
Takim me qytetarët e fshatit Polluzhë	Objekti shkollor 28.06.2022 20:30	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-DOBIDOL.pdf	0 14 14	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Polluzhë është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku kryesuese e komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Polluzhë ishin si në vijim:

Avdi Bajraktari – propozoi për kryetar të fshatit Polluzhë: Jonuz Hoti

Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Polluzhë nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Jonuz Hoti si kryetar i ri i fshatit Polluzhë.

Banorët e fshatit Polluzhë me akllamacion u përcaqtuan që keshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për keshillin e fshatit Polluzhë ishin si në vijim:

1. Jonuz Hoti
2. Isuf Hoti
3. Avdi Bajraktari
4. Baki Bajraktari
5. Qemaj Dula

Konstatim: Me akllamacion u votuan edhe anëtarët e keshillit të fshatit Polluzhë në përberje prej 5

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan kryesinë e re të keshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 21:00.

FSHATI KRAMOVIK

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës	F M T
Takim me qytetarët e fshatit Kramovik	Objekti shkollor 29.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-KRAMOVIK-GUR-I-KUQ-DHE-MRASOR.pdf	0 17 17	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Kramovik është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit.

Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Kramovik ishin si në vijim:

Jemin Thaqi – propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Kramovik : Binak Berisha.

Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Kramovik nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Binak Berisha si Kryetar i ri i fshatit Kramovik.

Banorët e fshatit Kramovik me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Kramovik ishin si në vijim:

1. Binak Berisha
2. Avdi Thaqi
3. Nisret Berisha
4. Mehmet Krasniqi
5. Agim Kelmendi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Kramovik në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 40.

FSHATI GURI I KUQ

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës F M T
Takim me qytetarët e fshatit Guri i Kuq	Objekti shkollor 29.06.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-KRAMOVIK-GUR-I-KUQ-DHE-MRASOR.pdf	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Guri i Kuq u zhvillua ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit hapi takimin dhe informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Guri i Kuq ishin si në vijim:

- Dul Gjemaj propozoi – Faton Fetahaj
- Azem Mustafa propozoi – Drilon Mustafa

Pasi që ishin më shumë se dy kandidatë të propozuar të dy kandidatët ju nënshtruan procesit të votimit të fshehtë.

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 81.

- Fletëvotime të vlefshme- 79
- Faton Fetahaj mori gjithsej : 40 vota
- Drilon Mustafa mori gjithsej: 39 vota

Me 40 vota gjithsej Faton Fetahaj u zgjodh kryetar i keshillit te fshatit Guri i Kuq i cili me nje fjaie rasti falenderoi te gjithë për besimin duke cituar se se bashku me keshillin do punojne ne te mire te fshatit.

Me propozimin e qytetarëve te fshatit Ratkoc dhe aprovimin e tyre keshilli i fshatit Dejne do te ketë gjithsej 5 anëtarë.

Te propozuarit per keshillin e fshatit Guri i Kuq ishin si ne vijim:

Faton Fetahaj

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e keshillit te fshatit Dejne ne përbërje prej 5 anëtarësh.
Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re te keshillit te fshatit, duke u dëshiruar pune te mbare dhe suksese ne vazhdimësi!

Takimi përfundoi ne ora 19:55.

FSHATI MRASOR

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Mrasor	Objekti shkollor 29.06.2022 20:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KESHILLAVE-TE-FSHATRAVE-KRAMOVIK-GUR-I-KUQ-DHE-MRASOR.pdf	0 6 6

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve te keshillit lokal dhe kryetarit te keshillit te fshatit Mrasor është zhvilluar, ashtu sic ishte e parapare ne orarin e publikuar. Te pranishëm ishin te gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi te pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojne procedurat për zgjedhjen e anëtarëve te keshillit lokal dhe kryetarit te keshillit te fshatit.

Te propozuarit për kryetar keshilli te fshatit Mrasor ishin si ne vijim:

Gezim Malsori – propozoi për kryetar te keshillit te fshatit Mrasor: Kujtim Rexhepi

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Mrasor nuk kishin propozime te tjera, u hodh ne votim dhe u votua

ne mënyrë unanime për z. Kujtim Rexhepi si Kryetar i ri i fshatit Mrasor .

Banorët e fshatit Mrasor me aklamacion u përcakatuan qe keshilli i fshatit te ketë 5 anëtarë.
Te propozuarit për keshillin e fshatit Mrasor ishin si ne vijim:

1. Kujtim Rexhepi
2. Gzim Mrasori
3. Driton Mrasori
4. Endrit Mrasori
5. Jeton Mrasori

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Mrasor në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 20: 40.

FSHATI FORTESE

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Fortesë	Objekti shkollor 30.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-FORTESE-DHE-SAPNIQ.pdf	0	14	14

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Fortesë nuk është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar, andaj në koordinim me kryesinë e fshatit kemi lënë një takim tjetër të cilin e zhvilluam më datë :12.08.2022.Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Fortesë ishin si në vijim:

Besnik Popaj– propozi për kryetar të këshillit të fshatit Fortesë- Elmi Popaj.

Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Fortesë nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Elmi Popaj si Kryetar i ri i fshatit Fortesë .

Banorët e fshatit Fortesë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Fortesë ishin si në vijim:

Hilmi Popaj

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Fortesë në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 20: 00.

FSHATI SAPNIQ

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Sapniq	Objekti shkollor 30.06.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-FORTESE-DHE-SAPNIQ.pdf	0 36 36

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit Sapniq është zhvilluar, ashtu siç ishte e parapare në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të keshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Sapniq ishin si në vijim:

Safet Gashi – propozim për kryetar të keshillit të fshatit Sapniq: Mensur Gashi

Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Sapniq nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Kujtim Rexhepi si Kryetar i ri i fshatit Sapniq.

Banorët e fshatit Sapniq me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 9 anëtarë.

Të propozuarit për keshillin e fshatit Sapniq ishin si në vijim:

1. Mensur Gashi

2. Naim Gashi

3. Ilir Thaqi

4. Mithat Gashi

5. Elami Morina

6. Fadil Gashi

7. Arben Gashi

8. Remzi Gashi

9. Safet Gashi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Keshillit të fshatit Sapniq në përbërje prej 9

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Keshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 45.

FSHATI XËRXË

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Xërxë	Objekti Shtëpisë së Kulturës 01.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-XERXE.pdf	5 133 138

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Xërxë është zhvilluar ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Takimin e hapi kryetari Murat Kryeziu i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe kryesinë për kontributin. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Xërxë ishin si në vijim:

- Hysen Kryeziu propozoi – Murat Kryeziu
- Egzon Thaqi propozoi – Artan Thaqi

Pasi që ishin dy kandidatë të propozuar të dy kandidatët ju nënshtuan procesit të votimit të fshehtë.

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 138.

- Fletëvotime të vlefshme- 0
- Artan Thaqi mori gjithsej : 75 vota
- Murat Kryeziu mori gjithsej: 63 vota

Me 75 vota gjithsej Artan Thaqi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Xërxë, i cili me një fjalë rasti falënderoi të gjithë për besimin duke cituar se së bashku me këshillin do punojnë në të mirë të fshatit.

Me propozimin e qytetarëve të fshatit Xërxë dhe aprovimin e tyre këshilli i fshatit Xërxë do të ketë gjithsej 9 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Xërxë ishin si në vijim:

1. Artan Thaqi
2. Armend Kryeziu
3. Behar Thaqi
4. Haxhi Berisha
5. Jehona Kryeziu
6. Ali Sinani
7. Hekuran Thaqi
8. Fadil Kryeziu
9. Fatlind Gashi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Xërxë në përbërje prej 9 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 45.

FSHATI PATAQAN I ULËT

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës F M T
Takim me qytetarët e fshatit Pataqan i Ulët	Objekti shkollor 04.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJFOTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-PATAQAN-I-ULET-PATAQAN-I-EFERM-DHE-NUSHPALE.pdf	0 16 16

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Pataqan i Ulët është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Pataqan i Ulët ishin si në vijim:

Neki Sulejmani – propozoi për kryetar të keshillit të fshatit Pataqan i Ulët; Kushtrim Zeka
Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Pataqan i Ulët nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z.Kushtrim Zeka si kryetar i ri i fshatit Pataqan i Ulët.

Banorët e fshatit Pataqan i Ulët me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 9 anëtarë. Të propozuarit për keshillin e fshatit Pataqan i Ulët ishin si në vijim:

Kushtrim Zeka

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e keshillit të fshatit Pataqan i Ulët në përberje prej 9 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan kryesinë e re të keshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 18: 45.

FSHATI PATAQAN I EFERM

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës F M T
Takim me qytetarët e fshatit Pataqan i Eferm	Objekti shkollor 04.07.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJFOTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-PATAQAN-I-ULET-PATAQAN-I-EFERM-DHE-NUSHPALE.pdf	

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Pataqan i Eferm është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit.

Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Pataqan i Epërm ishin si në vijim:

Elmi Ymeri – propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Pataqan i Epërm: Selim Bellaqa

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Pataqan i Epërm nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Selim Bellaqa si Kryetar i ri i fshatit Pataqan i Epërm.

Banorët e fshatit Pataqan i Epërm me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Pataqan i Epërm ishin si në vijim:

1. Selim Bellaqa
2. Elmi Ymeri
3. Hidajet Maliqi
4. Nazmi Bellaqa
5. Arben Bellaqa

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Pataqan i Epërm në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 45.

FSHATI NUSHPAL

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Nushpal	Objekti shkollor 04.07.2022 20:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJFOTIM-ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-PATAQAN-I-ULET-PATAQAN-I-EPERM-DHE-NUSHPALLE.pdf	0	12	12

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Nushpal është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit.

Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Nushpal ishin si në vijim:

Besnik Kastrati propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Nushpal – Fatmir Morina.

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Nushpal nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Fatmir Morina si Kryetar i ri i fshatit Nushpal.

Banorët e fshatit Nushpal me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Nushpal ishin si në vijim:

1. Fatmir Morina
2. Besnik Kastrati

3. Luizim Morina
4. Faton Morina
5. Arben Berisha

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Nushpal në përberje prej 5

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 20: 45.

FSHATI DRENOC

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
			F M T
Takim me qytetarët e fshatit Drenoc	Objekti i Shtëpisë së Kulturës 05.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-DRENOC-DHE-ZATRIQ.pdf	0 20 20

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit lokal dhe kryetarit të Këshillit të fshatit Drenoc është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit lokal dhe kryetarit të Këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar Këshilli të fshatit Drenoc ishin si në vijim:

Sherif Haxhiu propozoi për kryetar të Këshillit të fshatit Drenoc – Artan Asllani

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Drenoc nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Artan Asllani si kryetar i ri i fshatit Drenoc

Banorët e fshatit Drenoc me aklamacion u përcaktuan që Këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë. Të propozuarit për Këshillin e fshatit Drenoc ishin si në vijim:

1. Artan Asllani
2. Besim Bajrami
3. Arsim Kastrati
4. Sherif Haxhiu
5. Kajta Berisha
6. Jemin Makschan
7. Lirim Zyberaj

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Drenoc në përberje prej 7

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 18: 45

FSHATI ZATRIQ

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Zatriq	<u>Objekti shkollor</u> <u>05.07.2022</u> <u>19:00</u>	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-DRENOC-DHE-ZATRIQ.pdf	0	16	16

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Zatriq është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Zatriq ishin si në vijim:

Bledar Kastrati propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Zatriq – Ismet Kastrati.

Konstatim: Megjë qytetarët e fshatit Zatriq nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Ismet Kastrati si Kryetar i ri i fshatit Zatriq.

Banorët e fshatit Zatriq me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Zatriq ishin si në vijim:

1. Ismet Kastrati
2. Gëzim Kastrati
3. Edonis Kastrati
4. Arsim Kastrati
5. Ismet Vehapi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Zatriq në përbërje prej 5 anëtarësh. Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 40.

FSHATI SENOC

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Senoc	<u>Objekti shkollor</u> <u>06.07.2022</u> <u>18:00</u>	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-SENOC-PASTASELLE-DHE-KAZNIK.pdf	0	19	19

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Senoc nuk është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar, andaj në koordinim me kryesinë e fshatit kemi lënë një takim tjetër të cilin e zhvilluam më datë :17.08.2022.Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku kryesuese e komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Senoc ishin si në vijim:
Adem Krasniqi – propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Senoc – Daut Krasniqi.
Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Senoc nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Daut Krasniqi si Kryetar i ri i fshatit Senoc .

Banorët e fshatit Fortesë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.
Të propozuarit për këshillin e fshatit Senoc ishin si në vijim:

Daut Krasniqi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e këshillit të fshatit Senoc në përbërje prej 5 anëtarësh.
Anëtarët e komisionit, uruan kryesinë e re të këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 19: 00.

FSHATI PASTASEL

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarët e fshatit Pastasel	Objekti shkollor 06.07.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-SENOC-PASTASELE-DHE-KAZNIK.pdf	1 22 23

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Pastasel është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku kryesuese e komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Pastasel ishin si në vijim:
Shaqir Krasniqi propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Pastasel – Afrim Krasniqi.
Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Pastasel nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Afrim Krasniqi si Kryetar i ri i fshatit Pastasel.

Banorët e fshatit Pastasel me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë.
Të propozuarit për këshillin e fshatit Pastasel ishin si në vijim:

1. Afrim Krasniqi

2. Jeton Krasniqi
3. Afrim Krasniqi
4. Nazim Mazreku
5. Hysen Krasniqi
6. Qerim Krasniqi
7. Skender Krasniqi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Pastasel në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 40.

FSHATI KAZNIK

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës F M T
Takim me qytetarët e fshatit Kaznik	Objekti shkollor 06.07.2022 20:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/ZGJEDHJA-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-SENOC-PASTASELLE-DHE-KAZNIK.pdf	0 0 0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Kaznik ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të fshatit Kaznik është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të Këshillit të fshatit Kaznik.

FSHATI OPTERUSHË

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës F M T
Takim me qytetarët e fshatit Opterushë	Objekti shkollor 07.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-TE-FSHATRAVE-DHE-LAGJEVE-URBANE-OPTERUSHE-DHE-ZOQISHT.pdf	2 55 57

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Opterushë është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Takimin e hapi kryetari Skender Krasniqi i cili falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe kryesinë për kontributin. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit.

Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtën e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Opterushë ishin si në vijim:

- Bahudin Spahiu propozoi – Skender Krasniqi
- Sedat Kabashi propozoi – Fadil Mazreku

Pasi që ishin dy kandidatë të propozuar të dy kandidatët ju nënshtruan procesit të votimit të fshehtë.

Procesi i votimit ka ecur me rregull dhe sipas procedurave, gjithsej votues ishin 57.

- Fletëvotime të vlefshme-0

- Fadil Mazreku mori gjithsej : 28 vota

- Selver Mazreku mori gjithsej: 29 vota

Me 29 vota gjithsej Skender Krasniqi u zgjodh kryetar i këshillit të fshatit Opterushë, i cili me një fjalë rasti falënderoi të gjithë për besimin duke cituar se së bashku me këshillin do punojnë në të mirë të fshatit.

Me propozimin e qytetarëve të fshatit Opterushë dhe aprovimin e tyre këshilli i fshatit Opterushë do të ketë gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Opterushë ishin si në vijim:

1. Skender Krasniqi

2. Hamdi Dulaku

3. Hamdi Mazreku

4. Beni Kabashi

5. Bahrudin Spahija

6. Bashkim Kabashi

7. Baki Elshani

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e këshillit të fshatit Opterushë në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbare dhe suksese në vazhdimësi!
Takimi përfundoi në ora 18: 45.

FSHATI ZAQISHT

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Takim me qytetarët e fshatit Zaqisht
Pjesëmarrës F M T	Njoftimi i publikuar	Objekti shkollor 07.07.2022 19:00
		https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETARVE-TE-FSHATRAVE-DHE-LAGJEVE-URBANE-OPTERUSHE-DHE-ZOQISHT.pdf

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Zaqisht është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtarët e Komisionit informuan ë pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Zaqisht ishin si në vijim:

Hamza Kabashi propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Zaqisht – Enver Kabashi.

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Zaqisht nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Enver Kabashi si Kryetar i ri i fshatit Zaqisht.

Banorët e fshatit Zaqisht me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Zaqisht ishin si në vijim:

Enver Kabashi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Zaqisht në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 40.

FSHATI HOÇË E MADHE

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Hoçë e Madhe	Objekti i Shtëpisë së Kulturës 11.07.2022 17:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-DHE-KESHILLAVE-LOKAL-HOCE-E-MADHE.pdf	0	0	0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të fshatit Hoçë e Madhe është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

RAHOVEC – LAGJJA I

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarë të Lagjes Rahoveci I	Objekti shkollor 11.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJE-TE-KRYETAREVE-LAGJJA-I-DHE-II.pdf	6	12	18

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të Lagjes Rahoveci I është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të lagjes.

Të propozuarit për kryetar këshilli të Lagjes Rahoveci I ishin si në vijim:

Luan Danuza propozoi për kryetar të këshillit- Xhabir Hajrullaga.

Konstatim: Mëqë qytetarët e Lagjes Rahoveci I nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Xhabir Hajrullaga i si Kryetar i ri i Lagjes Rahoveci I

Me propozimin e qytetarëve dhe aprovimin e tyre këshilli i Lagjes Rahoveci I do të ketë gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për keshillin e Lagjes Rahoveci I ishin si në vijim:

Xhabir Hajrullaga

Konstatim: Me akklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të Lagjes Rahoveci I në përbërje prej 7

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të Lagjes Rahoveci I duke u dëshiruar punë të mbare dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 40.

RAHOVEC – LAGJA II

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
Takim me qytetarë të Lagjes Rahoveci II	Objekti shkollor 11.07.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJE-TE-KRYETAREVE-LAGJA-I-DHE-II.pdf	0 21 21

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të Lagjes Rahoveci II është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të lagjes.

Të propozuarit për kryetar këshilli të Lagjes Rahoveci II ishin si në vijim:

Fatos Hasku propozoi për kryetar të këshillit- Teki Mustafa.

Konstatim: Megjë qytetarët e Lagjes Rahoveci II nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Teki Mustafai si Kryetar i ri i Lagjes Rahoveci II

Me propozimin e qytetarëve dhe aprovimin e tyre këshilli i Lagjes Rahoveci II do të ketë gjithsej 7 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e Lagjes Rahoveci II ishin si në vijim:

1. Teki Mustafa
2. Veton Mustafa
3. Fatos Hasku
4. Nazim Velu
5. Jusuf Dërmala
6. Fehmi Shehu
7. Masar Vuçitërrna

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të Lagjes Rahoveci II në përbërje prej 7 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të Lagjes Rahoveci I duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 45.

RAHOVEC – LAGJJA III

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarë të Lagjes Rahoveci III	Objekti shkollor 12.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-LAGJJA-III-DHE-IV.pdf	0	11	11

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të Lagjes Rahoveci III është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Nora Boshnjaku Kryesuese e Komisionit informoi të pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të lagjes.

Të propozuarit për kryetar këshilli të Lagjes Rahoveci III ishin si në vijim:

Rexhep Rexha propozoi për kryetar të këshillit – Edmir Sokoli.

Konstatim: Megjë qytetarët e Lagjes Rahoveci III nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Edmir Sokoli si Kryetar i ri i Lagjes Rahoveci III.

Me propozimin e qytetarëve dhe aprovimin e tyre këshilli i Lagjes Rahoveci III do të ketë gjithsej 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e Lagjes Rahoveci III ishin si në vijim:

1. Edmir Sokoli

Konstatim: Me akllamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të Lagjes Rahoveci III në përberje prej 5

anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të Lagjes Rahoveci I duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 45.

RAHOVEC – LAGJA IV

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
F M T			
Takim me qytetarë të Lagjes Rahoveci IV	Objekti shkollor 12.07.2022 19:30	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-LAGJA-III-DHE-IV.pdf	0 0 0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit lokal dhe kryetarit të Këshillit të Lagjes Rahoveci IV ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të Lagjes Rahoveci IV është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të Këshillit të Lagjes Rahoveci IV.

RAHOVEC – LAGJA V

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës
F M T			
Takim me qytetarë të Lagjes Rahoveci V	Objekti shkollor 13.07.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-LAGJA-V.pdf	0 0 0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit lokal dhe kryetarit të Këshillit të Lagjes Rahoveci V ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillave lokal, nuk është mbajtur për arsye të mos prezencës së qytetarëve në këtë takim. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit, dhe në koordinim me kryesinë e kaluar të Lagjes Rahoveci V është vendosur që takimi i radhës të mbahet atëherë kur qytetarët të jenë të gatshëm të zgjedhin kryesinë dhe kryetarin e ri të Këshillit të Lagjes Rahoveci V.

FSHATI RETIJË

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Retijë	Objekti shkollor 14.07.2022 18:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-RETIJE-DHE-RETIJE-E-ULET.pdf	0	16	16

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit Retijë është zhvilluar, ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtarët e Komisionit informuan ë pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit lokal dhe kryetarit të këshillit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar këshilli të fshatit Retijë ishin si në vijim:

Jetmir Krasniqi propozoi për kryetar të këshillit të fshatit Retijë – Ilir Kryeziu.

Konstatim: Megë qytetarët e fshatit Retijë nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Ilir Kryeziu si Kryetar i ri i fshatit Retijë.

Banorët e fshatit Retijë me aklamacion u përcaktuan që këshilli i fshatit të ketë 5 anëtarë.

Të propozuarit për këshillin e fshatit Retijë ishin si në vijim:

1. Ilir Krasniqi
2. Rrahim Thaqi
3. Dardan Kryeziu
4. Fevzi Thaqi
5. Ramadan Krasniqi

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e Këshillit të fshatit Retijë në përbërje prej 5 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Këshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 18: 40.

FSHATI RETIJË E ULËT

Takimi	Vendi, data dhe ora e mbajtjes së takimit	Njoftimi i publikuar	Pjesëmarrës		
			F	M	T
Takim me qytetarët e fshatit Retijë e Ulët	Objekti shkollor 14.07.2022 19:00	https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2022/06/NJOFTIM-PER-ZGJEDHJEN-E-KRYETAREVE-RETIJE-DHE-RETIJE-E-ULET.pdf	0	20	0

Procesi për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit Retijë është zhvilluar ashtu siç ishte e paraparë në orarin e publikuar. Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e komisionit. Anëtarët e komisionit informuan ë pranishmit për vajtjen e procesit dhe se si vijojnë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të keshillit lokal dhe kryetarit të fshatit.

Të propozuarit për kryetar keshilli të fshatit Retijë e Ujëit ishin si në vijim:

Ismet Ademi propozoi për kryetar të keshillit të fshatit Retijë e Ujëit – Mirsad Qehaja.

Konstatim: Meqë qytetarët e fshatit Retijë e Ujëit nuk kishin propozime të tjera, u hodh në votim dhe u votua në mënyrë unanime për z. Mirsad Qehaja si kryetar i ri i fshatit Retijë e Ujëit.

Banorët e fshatit Retijë e Ujëit me aklamacion u përcaktuan që keshilli i fshatit të ketë 3 anëtarë. Të propozuarit për keshillin e fshatit Retijë e Ujëit ishin si në vijim:

1. Mirsad Qehaja
2. Rexhep Shapi
3. Bekim Shabani

Konstatim: Me aklamacion u votuan edhe anëtarët e keshillit të fshatit Retijë e Ujëit në përzierje prej 3 anëtarësh.

Anëtarët e Komisionit, uruan Kryesinë e re të Keshillit të fshatit, duke u dëshiruar punë të mbarë dhe suksese në vazhdimësi!

Takimi përfundoi në ora 19: 40.

Në vazhdim po paraqesim vetëm nga disa fotografitë e bëra gjatë procesit për zgjedhjen e Kryetarëve dhe Këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve në Komunën e Rahovecit





PËRFUNDIM

Takimet për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të lagjeve urbane, fshatrave dhe vendbanimeve organizohen nga anëtarët e kuvendit dhe qeverisë komunale të Rahovecit.

Emrat e anëtarëve të komisionit.

- Melinda Oruqi, anëtar/e i Kuvendit të Komunës 
- Afrim Berisha, anëtar/e i Kuvendit të Komunës 
- Faton Ramadani, anëtar/e i Kuvendit të Komunës 
- Leonard Morina, anëtar/e i Kuvendit të Komunës 
- Vjollca Gurgule, anëtar/e nga shoqëria civile _____
- Nora Boshnjaku, anëtar/e nga ekzekutivi i Komunës
- Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjes urbane në qytet



Nora Boshnjaku
Kryetare e Komisionit







Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, Ligjit Nr. 08/L-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.06.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 - 2022 në vitin 2023

1. **Miratohet vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021-2022 në vitin 2023 në shumë prej 490,416.01€ (katërqind e nentëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë euro e një cent)**
2. **Mjetet në shumën prej 432,148.37€ (katërqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e katërdhjetë e tetë euro e tridhjetë e nëntë cent) nga fondi burimore (21) do të barten në vitin 2023 në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:**
 - Nga fondi Burimor (21) në kategorinë e investimeve kapitale në shumë prej 339,879.98€:
 - 2.1. Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**
 - 2.1.1 Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë, kodi (53790) në shumë prej 11,732.36€;
 - 2.1.2. Ndërtimi rregullimi kanalizimeve fekale (Gropa Septike) Krushe e Madhe, Dejne, Ratkoc, Dobidol, Radoste, Rahovec, Xerxe, Gexhe, kodi (53866) në shumë prej 50,000.00€;
 - 2.1.3. Ndërt. i kan. për ujëra atmos. dhe ndërt. i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq, kodi 48181 në shumë prej 7,100.00€
 - 2.2 Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**
 - 2.2.1. Rregullimi shtreterve lumenjve prockave Krushe Madhe, Polluzhë, Radoste, Dejnë Celin, Sapniq, kodi (53800) në shumën prej 100,000.00€.
 - 2.2.2. Rregullimi varrezave Dëshmorëve dhe Civileve Celinë-Krushë Madhe, Opterushe, Ratkoc-Mrasor, Rahovec kodi (53858) në shumën prej 20,000.00€;
 - 2.3 Në programin Kulturë, Rini, Sport (850), nën Shërbimet Kulturore – Rahovec (85011), kodi funksional (0820).**
 - 2.3.1 Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe, kodi (50753) në shumën prej 25,000.00€;

2.3.2 Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së kulturës Celinë (projekt i ri), në shumën prej 35,000.00€

2.4. Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimi parashkollor (92410), kodi funksional (0911)

2.4.1. Ndërtimi i qerdhes ne Ratkoc, kodi (45787) në shumën prej 1,600.00€;

2.5 Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93300), kodi funksional (0912)

2.5.1. Ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë, kodi (48090) në shumën prej 45,000.00€;

2.5.2. Renovimet në shkollat Rahovec, Qifllak, Zoqishtë, kodi (53783) në shumë prej 43,447.62€

- Nga fondi burimor (21) në kategorinë e Subvencione dhe transfere në shumë prej 17,268.39 €:

2.6. Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451). Në shumë prej 16,998.39 €

2.7 Në programin Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën programi Shërbimet e shëndetësisë primare (73700), kodi funksional (0721), në shumë prej 270.00 €

- Nga fondi burimor (21) në kategorinë e Mallërave dhe Shërbimeve në shumë prej 76,000.00 €

2.8 Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën Programin Planifikimi Urban dhe Inspeksion (66360), kodi funksional (0620). Në shumë prej 76,000.00€

3. Nga fondi Burimor (22) në kategorinë e investimeve kapitale në shumë prej 58,267.64€:

3.1 Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).

3.1.1 Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë, kodi (53790) në shumë prej 58,267.64€;

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. ____/22
Datë: 27.06.2023

Defrim Kafexhiu

Kryesues i Kuvendit

FINALE					
Nr.	Kodi i projektit	Emri i projektit ne Buxhet	Bartja 21	Bartja 22	Totali
1	53790	Ndërtimi rrugëve Rahovec-Xerxe-Opterushë-Krushë Madhe-Gexhe-Kramovik-Hoqë	11,732.36	58,267.64	70,000.00
2	53866	Ndërtimi rregullimi kanalizimeve tekale (Gropa Septike) Krushë e Madhe, Dejne, Ratkoc, Dobidol, Radoste, Rahovec, Xerxe, Gexhe	50,000.00		50,000.00
3	48181	Ndërt. i kan. për ujëra atmos. dhe ndërt. i rrugëve me kubëza në fshatin Zatriq	7,100.00		7,100.00
4	53800	Rregullimi shpreterve lumenjve prrockave Krushë Madhe, Polluzhë, Radoste, Dejnë Celin, Sapniq	100,000.00		100,000.00
5	53858	Rregullimi varrezave Dëshmorëve dhe Civileve Celinë-Krushë Madhe, Opterushe, Ratkoc-Mrasor, Rahovec	20,000.00		20,000.00
6	50753	Ndërtimi i Muzeut në Krushë të Madhe	25,000.00		25,000.00
7	Projekt i ri	Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë së kulturës Celinë	35,000.00		35,000.00
8	45787	Ndertimi i qerdhes ne Ratkoc	1,600.00		1,600.00
9	48090	Ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë	45,000.00		45,000.00
10	53783	Renovimet në shkollat Rahovec, Qifllak, Zoqishtë	43,447.62		43,447.62
		Investime Kapitale	338,879.98	58,267.64	397,147.62
11		Mallëra dhe Shërbime	76,000.00		76,000.00
12		Subvencione	17,268.39		17,268.39
		Totali	432,148.37	58,267.64	490,416.01
		Shuma për Bartje	432,148.37		



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 00.06.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit 2024-2026 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1

1. **Miratohet** vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Rahovecit 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2024/1.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 dhe Qarkorja Buxhetore 2024/1.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. ____/23
Me datë:00.06.2023

Defrim Kafexhiu
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 2131 Më 09-06-2023
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) E KOMUNËS SË RAHOVECIT 2024-2026

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Përmbajtja:

Përmbajtja:	1
I. Hyrje	2
II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme	3
1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:	6
2. Forcimi i sektorit të bujqësisë	6
2.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor, si:	7
2.2. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit	8
3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim	8
4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe i mirëqenies së qytetarëve	9
1. Përmirësimi dhe mbrojtja e mjedisit, planifikimi urban dhe shërbimet publike komunale	10
2. Administratë e Përgjithshme	12
3. Rinia, kultura dhe sporti	12
III. Korniza Fiskale Komunale	13
3.1. Indikatorët ekonomik komunal	13
3.2. Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afatmesëm 2024-2026	15
3.3. Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afatmesëm 2024-2026	18

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë, është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB-i siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave, prioritetëve, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritetit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuara nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2024/01, të lëshuara nga Ministria e Financave, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve, prioritet të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

I

Draft KAB - it 2024-2026

Fillimi i qershorit



II

Kuvendi Komunal dhe Konsultimet

Mesi i qershorit



III

Publikimi i dokumentit të KAB-it 2024-2026

Fundi i qershorit



IV

Procesi vjetor i buxhetit 2024

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (gjegjësisht në subrajonin e Anadrinit). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike i mundëson asaj lidhje të mira me qendra të tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej 33 fshatra, 2 vendbanime të vogla dhe një qendër urbane, e ndarë në 5 lagje, me një popullsi prej 56,208 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011, e organizuar në 8.028 ekonomi familjare.

Mbi 1845 biznese operojnë brenda komunës sonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, rreth 16% në prodhimtari, 19% me transport etj.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përmes zyrave qendrore dhe zyrave lokale, që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosur në ndërtesën administrative të Komunës dhe 8 të tjera në fshatra, gjithashtu, Komuna e Rahovecit posedon tri E-kiosqe, një mundësi e mirë që qytetarëve u mundëson vetëshërbimin me dokumente administrative (certifikata të ndryshme).

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Rahovecit, i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë, bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjate strategjike që ka zhvilluar komuna, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të Qeverisë së Kosovës dhe të prioriteteve bazë të saj, si dhe në Qarkoren Buxhetore Komunale 2024-2026 (I), të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Rahovecit është: **"Të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një bujqësi të zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, me plane zhvillimore dhe urbane, shërbime shëndetësore efikase dhe cilësore, komunë e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, e afirmuar si një qendër e kulturës, e arsimit dhe e jetës sportive. Po ashtu, një komunë e zhvilluar, e fortë dhe me shërbime publike, administrative që ofrojnë cilësi të mirë të jetesës për të gjithë qytetarët e saj".**

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë, së pari, lehtësia e komunikimit, si dhe, së dyti, llogaridhënia, së treti, transparenca. Me qëllim të përmbushjes së këtyretributeve të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritetet strategjike të Komunës, në periudhën afatmesme, janë grupuar në pesë, e që do të mundësojnë realizimin e qëllimit e të vizionit tonë për komunën.

PRIORITETET:

- BUJQËSIA;
- EKONOMIA;
- AGROTURIZMI DHE PUNËSIMI;
- ADMINISTRATË BASHKËKOHORE ME SHËRBIME TË SHPEJTA DHE CILËSORE;
- ARSIMI, SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE;
- INFRASTRUKTURË PUBLIKE TË RREGULLUAR DHE TË MIRËMBAJTUR;
- INVESTIME NGA FONDI I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT;
- INVESTIME NË INFRASTRUKTURË KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRA PËR TË RINJTË, SI DHE RRITJA E PËRKRAHJES PËR KËTA SEKTORË;
- PROMOVIMI I POTENCIALIT DHE I MUNDËSIVE PËR INVESTIME NGA MËRGATA JONË;
- TRASHËGIMIA KULTURORE, HISTORIKE DHE INVESTIME PËR TA NDERUAR HARTËN E SAKRIFICËS DHE TË LIRISË.

ZOTIMET:

- KOMUNË E HAPUR PËR QYTETARËT - TRANSPARENCË E PLOTË DHE LLOGARIDHËNIE;
- KOMUNË QË QEVERISET DREJT DHE MIRË, LIGJSHËM DHE ME PERFORMANCË TË LARTË;
- KOMUNË KU U SHËRBEHET QYTETARËVE PA DALLIM;
- KOMUNË ME SHËRBIME GJITHNJË E MË BASHKËKOHORE;
- KOMUNË KU PROMOVOHEN POLITIKAT DHE PRAKTIKAT MË TË MIRA, SI DHE STANDARDET E LARTA TË QEVERISJES;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT NJERËZORE E QYTETARE;
- KOMUNË PA DISKRIMINIM E QË QYTETARËT I TRAJTON BARABARTË;

- KOMUNË KU RESPEKTOHEN VLERAT KOMBËTARE, HISTORIKE, VLERAT E LUFTËS DHE TË LIRISË;
- KOMUNË QË NDERON SAKRIFICËN DHE GJAKUN E DERDHUR PËR LIRI;
- KOMUNË QË TRAJTON DHE MBËSHTET QYTETARËT QË KANË NEVOJA TË VEÇANTA;
- KOMUNË QË NDERON, PROMOVON E I JEP PËRKRAHJE TRADITËS, TRASHËGIMISË DHE GJITHË PASURISË SONË TË PËRBASHKËT, GJITHË ASAJ QË ËSHTË VLERË DHE IDENTITET I RAHOVECIT;
- KOMUNË KU PËRFAQËSOHET, MBROHET DHE PUNOHET PËR INTERESIN PUBLIK;
- KOMUNË KU PËRKUSHTIMI PËR TË VEPRUAR NDERSHËM DHE NË PAJTIM ME LIGJIN, PËRVEÇSE VULLNET, PËRCAKTIM I TË ZGJEDHURVE, JETËSOHET EDHE SI DETYRIM MORAL NDAJ ZGJEDHËSVE, SI DHE NDAJ LIGJIT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHET MOZAIKU I VLERAVE NJERËZORE, DEMOKRATIKE, KULTURORE, TË TRASHËGIMISË E TË BESIMIT NË ZOT;
- KOMUNË KU RESPEKTOHEN PAKICAT DHE PROMOVOHEN VLERAT E TYRE.

SYNIMET:

- BUJQËSI TË PËRKRAHUR PËR KATËR VJET;
- INVESTIME NË RRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE, ZGJERIMIN E TYRE, ZGJATJEN E ORARIT TË SHËRBIMEVE, PAJISJE MJEKËSORE DHE INVENTARIZIM PËR QKMF-në DHE PËR TË GJITHË RRJETIN E SHËRBIMEVE PARËSORE SHËNDETËSORE;
- ARSIM CILËSOR DHE BIBLIOTEKA, PAJISJE BASHKËKOHORE, LABORATORË, MË SHUMË TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE MJETE KONKRETIZIMI NË SHKOLLA;
- HARTIMI I PLANEVE URBANE DHE NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT;
- KOLEKTORË DHE IMPIANT PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË ZEZA;
- ZHVILLIM EKONOMIK DHE PUNËSIM NËPËRMJET FUQIZIMIT DHE MBËSHTETJES SË SEKTORIT PRIVAT;
- PËRQENDRIM PËR ZHVILLIMIN E PLANIFIKUAR TË AGROTURIZMIT;
- QENDËR E MADHE MAGAZINUESE PËR RUAJTJEN E RRUSHIT, PEMËVE DHE PERIMEVE.

1. Forcimi i ekonomisë komunale me mundësi për të gjithë përmes:

Një ndër prioritet në mandatin qeverisës do të vazhdojë të mbetet zhvillimi ekonomik përmes politikave lehtësuese në taksë dhe mbështetje të bizneseve të reja, atyre të vogla dhe të mesme. Duke e pasur parasysh dëmin nga kriza pandemike, një qasje e re është e nevojshme për t'ua dhënë mundësinë e ringritjes bizneseve në komunën tonë.

- Funksionalizimi i Zonës Ekonomike në Optrushë – Aktualisht, Komuna e Rahovecit, ka memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për fazën e parë të ndërtimit të Zonës Ekonomike. Vlera e këtij memorandum është: 1,800,00,00€ dhe Komuna e Rahovecit do të bashkëfinancojë me 300,000,00€. Kostoja totale e këtij projekti është: 2,672,756,06€. Komuna e Rahovecit, është e përkushtuar deri në funksionalizimin e plotë të këtij projekti, me qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik lokal;
- Krijimi i hapësirave të reja për zhvillimin e bizneseve – Do të krijohen hapësira të reja për biznese në: Rahovec (pjesët më afër qytetit), Krushë të Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe në fshatrat më të mëdha e më të frekuentuara në komunën e Rahovecit. Gjithashtu, në zona ku ka potencial zhvillimi, do të përqipemi të krijojmë lehtësira dhe hapësira për investime nga sektori privat;
- Lehtësira në të bërit biznes - Lehtësim i taksave komunale, sipas sektorëve – Do të bëhen vlerësimet e nevojshme për të siguruar uljen e taksave për bizneset private;
- Mbështetja direkte dhe indirekte e bizneseve - Përkrahje për bizneset e reja, ato të vogla dhe të mesme. Me qëllim të përmirësimit të ambientit të të bërit biznes në komunë, do të ndihmohen veçanërisht sipërmarrësit e ri, të vegjël dhe të mesëm, përmes subvencionimit edhe të zejeve të veçanta dhe të aplikimit të taksave favorizuese për ta;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të moshuar;
- Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit dhe ndërtimi i shtigjeve të reja;
- Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare, si dhe dhënia në shfrytëzim përmes ankandeve publike;
- Mbështetja e turizmit dhe e agroturizmit;
- Rritja dhe modernizimi i tregjeve;
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes;
- Investime në zona turistike;
- Rritje e përkushtimit dhe e intensitetit të veprimeve për projekte të ndryshme dhe suksese të reja në PPP;
- Përfshirje e të rinjve në tregun e punës, me përkrahje direkte nga komuna e cila synon krijimin e mjediseve të përshtatshme dhe përkrahje me teknologji informative, ku përmes ideve të reja e projekteve konkrete (inovative) të hapet perspektivë për ta;
- Promovimi i turizmit në komunën e Rahovecit.

2. Forcimi i sektorit të bujqësisë

Zhvillimi dhe fuqizimi i sektorit të bujqësisë për të rritur bazën ekonomike dhe sociale në komunën tonë, duke qenë e harmonizuar me politikat dhe strategjinë e hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të strategjisë janë përfshirë të gjithë sektorët që zhvillohen në komunën tonë, me theks të veçantë: vreshtaria dhe perimekultura.

Në kuadër të strategjisë do të përfshihen programe të veçanta që do të ndikojnë direkt në përmirësimin e kushteve të punës për fermerët kultivues të pemëve dhe të perimeve.

Fokusi në këtë periudhë do të orientohet në këto drejtime, si:

- Zbatimi i projekteve që prekin direkt fermerët;
- Zbatimi i projekteve kapitale për ndërtimin e infrastrukturës bujqësore, dhe
- Zhvillimi i sektorit të turizmit rural - agroturizmit.

2.1. Përkrahje e fermerëve duke i klasifikuar për secilin sektor, si:

- Perimekulturë dhe pemëtari – Përkrahje fermerëve me farëra, plehra kimike dhe me inpute bujqësore;
- Investime në sipërfaqe të mbrojtura – serra (sipërfaqe 3 ari, 5 ari, 7 ari e deri në 10 ari, do të shohim mundësinë që kjo sipërfaqe të rritet në vazhdimësi);
- Përkrahja e bujqve për ngritje të fidanishteve për prodhim të fidaneve cilësore;
- Sektori i blegtorisë - shërbime veterinarë (vaksinimi, kontrollimi i kafshëve, repelimi etj.);
- Marrja e mostrave të tokave bujqësore për analiza;
- Sektori i bletarisë – investim në mbjellje me kultura të përshtatshme për bletë (Kolz),
- Sektori i vreshtarisë - inventar për trajtim të rrushit pas vjeljes;
- Sektori i verëtarisë- pajisje për prodhuesit dhe inventarë;
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe të perimeve;
- Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit;
- Hapja e tregjeve të reja në lokalitete të komunës sonë, si: funksionalizimi i tregut në Krushë të Madhe, kushte më të mira në tregun ekzistues në Xërxë, ndërtimin e tregut në qytetin e Rahovecit, po ashtu përfundimin e fazës së tretë të projektit “Infrastruktura e tregut të rrushit” - te Shtëpia e Verës;
- Në bashkëpunim me zyrën këshillimore, që operon në kuadër të MBPZHR-së, organizimin e trajnimeve për të gjithë sektorët e bujqësisë në komunën tonë;
- Këshillimi i fermerëve dhe marrja përsipër e përgatitjes së të gjitha dokumenteve dhe planeve të biznesit për aplikim në institucione të ndryshme, duke angazhuar ekspertë;

Menaxhimi me kujdes i tokës bujqësore komunale, duke i respektuar procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme përmes ankandit publik

- Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, stimulimi i tyre;
- Ndërtimi i rrugëve fushore, me theks të veçantë mirëmbajtja e tyre;
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet që rrezikojnë tokat bujqësore;
- Pastrimi dhe zgjerimi i përrrenjve që krijojnë probleme të vazhdueshme për fermerë;
- Mbrojtjen e tokave bujqësore nga degradimi – erozioni;
- Drenazhimi i tokave bujqësore;

- Rrjeti sekondar i sistemit të ujitjes në lokacione ku ekziston rrjeti primar, si dhe zgjerimi i rrjetit në pjesën kodrinore në koordinim me kompanitë publike, donatorët e jashtëm dhe Qeverinë që të kemi përparim dhe investime konkrete në këtë drejtim, në vitet e ardhshme qeverisëse për sigurim të ujit për ujitje, po ashtu, duke shfrytëzuar edhe burimet e tjera alternative të ujit.

2.2. Zhvillimi i sektorit të agroturizmit

- Investimi në ngritjen e bujtinave dhe investimi në infrastrukturë në zonat e shpallura turistike, si: Hapësira të burimi-Zhdrella, Burimi dhe shtegu në fshatin Zatriq, Pishat në fshatin Kaznik, Hapësira të Maja e Shkodranit, Vendi i quajtur Bllata, Kanioni Drini i Bardhë, ku aktivitetet e agroturizmit, si pjesë të një ose më shumë kategorive, janë: mikpritja (qëndrimi ose fjetja në bujtina për një ose disa net), rekreacioni (p.sh. shtegu i ecjes, gjuetia, kalërimi), dhe argëtimi (p.sh. dreka ose darka).
- Hapja e një zyre për informim dhe krijimi i një guide për turistët rreth zonave turistike të identifikuara në komunën e Rahovecit;
- Promovimi i zonave të përshtatshme për zhvillim të turizmit përmes Hartave dhe shënimit në tërë territorin e komunës sonë;
- Organizimi i festivaleve të ndryshme, që kanë karakter promovimi të produkteve bujqësore, që kultivohen në komunën tonë, si: Festa e Vjeljes së Rrushit – HardhFest, Agrofesta, panairë të ndryshme etj;
- Në sektorin e pylltarisë, do t'i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Mbrojtja dhe ruajtja e sipërfaqeve pyjore do të ketë vëmendje të shtuar;
- Toka, e cila është nën menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës (APK), do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe veprime që synojnë rritjen e cilësisë në arsim

- Ndërtimi dhe rinovimi i shkollave – Do të bëhet një rivlerësim i nevojës për objekte të reja shkollore në qytetin dhe fshatrat e Rahovecit. Në bazë të këtij rivlerësimi, Komuna e Rahovecit do të investojë që të rinovohen apo ndërtohen objektet e reja të arsimit fillor dhe të mesëm;
- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim;
- Eficienca e energjisë në shkolla, sipas nevojave;
- Investime në mjete konkretizimi të laboratorike, teknologji informative, tabela digjitale dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra;
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, këshillave drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe këshillave të nxënësve;
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla përmes angazhimit të një numri të caktuar të psikologëve dhe të pedagogëve, tashmë të punësuar;
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimeve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim. Trajnimet do të mbahen sidomos me mësimeve në fëmijë;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit edukativ - arsimor në shkolla, përmes Komisionit për Monitorim, të themeluar nga DKA-ja;
- Funksionalizimi i plotë i 3 çerdheve për fëmijë, të sapondërtuara.

- Organizimi dhe mbajtja periodike e garave të diturisë për nxënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar në shumicën e lëndëve mësimore;
- Zgjerimi i Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta – Siç e dimë, DKA-ja në katër vitet e fundit, në bashkëpunim me Ekipet Profesionale të saj, ka arritur që për herë të parë të hartojë dhe të vërë në përdorim Pakon Pedagogjike për klasat parafillore dhe klasat e programit fillor (1-5). Kjo Pako Pedagogjike është hartuar dhe tashmë do të vihet në përdorim edhe për klasat e larta (6-9), po ashtu edhe për klasat 10-12. Me zgjerimin e saj, në komunën tonë, do të ketë Pako Pedagogjike unike për të gjithë mësimdhënësit e të gjitha shkollave;
- Vazhdimi i funksionimit të suksesshëm të Qendrës Arsimore për nxënësit e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe themelimi e funksionalizimi edhe i një Qendre të Dytë Arsimore për këto komunitete në Shkollën Gëzim Hamza-Piktori. Komuna jonë do të kujdeset që Qendrat Arsimore për nxënësit e këtyre komuniteteve të vazhdojnë funksionimin e tyre normal, duke mundësuar arsimim dhe edukim shtesë për fëmijët e këtyre komuniteteve;
- Vazhdimi i funksionimit të Qendrave të Karrierës në SHML “Xhelal Hajda-Toni” dhe në IAAP “Selajdin Mullabazi – Mici”;
- Bursa për studentë dhe përkrahje gjithë atyre profesionistëve që na përfaqësojnë si komunë ose si shtet e na bëjnë krenar me dijet dhe shkathtësitë e tyre;
- Edukim për kategoritë me nevoja të veçanta – Komuna do të ofrojë transport, por edhe kushte specifike të mësimnxënies, duke iu përshtatur nevojave dhe kapaciteteve të tyre për vijimin e mësimi;
- Më shumë çerdhe – Qeverisja lokale, duke e parë nevojën për çerdhe të reja, do të investojë për hapjen e tyre në zona urbane, por edhe në vendbanime të mëdha rurale ku nuk ka çerdhe në afërsi, përmes Partneritetit Publiko- Privat, pas studimit të nevojave që do t'i kemi.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe i mirëqenies së qytetarëve

- Rritje e standardit të shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit të mirë dhe profesional. Në bashkëpunim me nivelin qendror, do të investohet në pajisje të reja e kapacitete njerëzore, për ta mundësuar rritjen e kapaciteteve dhe të kualitetit të shërbimeve të ofruara;
- Investime në maternitet - Do të përmirësojmë kushtet në maternitetin e Rahovecit, përmes angazhimit të stafit profesional dhe të sigurimit të pajisjeve të reja për stafin shëndetësor;
- Ndihma momentale për pacientët me sëmundje terminale - Komuna e Rahovecit do të ndajë një fond për t'u dalë në ndihmë pacientëve me sëmundje të rënda, përmes mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve;
- Shëndeti mendor – Do të angazhojmë ekipe profesionale (psikologë, pedagogë, punëtorë social, logopedë etj.) për ofrimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për këto lloj shërbimesh, si dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për bashkëpunim sa më funksional dhe koordinim sa më të mirë me Qendrën Rajonale të Shëndetit Mendor në Gjakovë;
- Pediatri në QKMF dhe vizita pediatrie nëpër çerdhe – Departamenti i Pediatrisë në Komunën e Rahovecit do t'i rrisë kapacitetet dhe do të ofrojë shërbime të zgjeruara, siç është ofrimi i shërbimeve të pediatri nëpër çerdhet e komunës;
- Riorganizimi i QKMF-së, për më shumë funksionalitet;
- Subvencionim për rastet e sëmundjeve për personat pa të ardhura/të ardhura të ulëta;
